

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 244, Shkurt 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

GJIN MARKAJ, DJALI I DUKAGJINIT NË NJU JORK BËN GJITHÇKA TË MUNDËR PËR VENDLINDJEN

2

- BIJTË E SHALËS NË MËRGIM PËR TROJET E TYRE -

Historikisht Shala dhe i gjithë Dukagjini kanë qenë një burim i pashterur burrash të zgjuar, mendimtarë dhe strateg përballë të gjitha sfidave dhe rreziqeve që janë kanosur krahinës dhe të gjithë Shqipërisë. Në kohët që po jetojmë shikojmë një shterim të burimit të këtyre virtyteve siç janë ato të dashurisë, mirënjohjes, humanizmit dhe aq më tepër të nacionalizmit të njerëzve në shumë aspekte. Ndoshta është shkaktar fenomeni i kohës së internetit, i cili ndikon sot në këtë shterim. Shumëkush sot nuk po pyet për të afërmit e vet, lanë pastaj për nacionalizmin kombëtar. Ky fenomen përgjithësisht për fat të keq po zgjerohet. Mosmirënjohja thuajse është institucionalizuar, duke arrit deri në nivelin e papërgjegjshmërisë. Rasti më flagrant është mos përcaktimi prej afro dy vitesh i vendosjes së bustit madhështor të Lekë Dukagjinit, nga pushteti lokal, për këtë vepër djemtë e dukagjinit kanë kontribuar në shumata të mëdha.

NJË LIBËR ME VLERË TË VEÇANTË PËR HISTORINË SHQIPTARE TË SHEKULLIT XVII

Rreth botimit të "Relatione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Min.ri Oss.ti Rifort.ri Del serafico P'rè S. Francisco nel Regno d'Albania" të Giacinto Sospello, sjellë në shqip nga Dr. Mark Planikaj, studiuesi i njohur i arkivave.

Etërit françeskanë nga Italia, që kryen misionin e tyre jashtëzakonisht të vështirë në Shqipërinë qendrore-veriore në shekullin XVII, në u detyrohemi edhe për relacionet e tyre që pasqyrojnë përditshmërinë shqiptare. Raportet përmbajnë përshkrime të territorit dhe të jetës së ditshme të popullsisë ...

7

BASHKËBISEDIM ME GAZETËN "THYMAS", MEDIA E INSTITUTIT PËR STUDIME ÇAME

Ju lutem, më flisni për veten, historinë e familjes suaj dhe jetën profesionale.

Çështjen kombëtare e ka përcjellë çdo gjeneratë si popull, por edhe si poetë, që nga Buzuku e më tej. Janë poetët ata që në një formë janë arma e mbrojtjes së atdheut dhe në çdokohë dhe që kanë treguar se identifikohen me vetë Shqipërinë, atdheun, pra janë çdo herë pararojë. Duke qenëqëedhene, kemi qenënjë gjeneratë që kemi përjetuar dhimbje dhe plagë atdheu, kemi marrë parasyshtënie të bukura poetësh si "Nëse thua diçka të re, e dëgjoni e lexoj, nëse nuk thua diçka të re, më ... Është ...

12


BUJARIA TROPOJANE TRADITË HISTORIKE E SHQIPTARISË

Vitet 90-ta të shekullit të kaluar, për popullin shqiptarë në Kosovë, dhe mbarë shqiptarët kudo, do mbesin të shkruara në faqet e historisë, si ndër vitet më të vështira brenda një shekulli, që nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912. Që nga shkëputja nga trualli amnorë i Shqipërisë dhe mbetja nën sundimin e titistëve Jugosllav, kulshedra sllaviste e Karpateve, gjithnjë e gjithmonë, me qëndrimet e saja hegjemoniste, e te mykur kokash nga shovinizmi, gjatë gjithë historisë së tyre shekullore, iu vërsulen një populli të pafajshëm në trojet e veta etnike. Pasionet e hegjemonisë sllave gjatë tërë shekullit të kaluar, ishin të stërngarkuar me veprime gjenocidiale, ...

14

I SHKRETI...

Mu kujtua një shprehje që unë e kisha dëgjuar mbi gjysëm shekulli më parë. Mbase më nxiti mendimet ndonjë veprimtari dhe qëndrime në shkrime të ndryshme të shtypit, pse jo edhe botime librash...



SHQIPTARË, KUDO QË JENI, FLISNI SHQIP ME FËMIJËT TUAJ

Emigracioni, gjatë gjithë periudhave të historisë, ka qenë dhe është një fenomen tipik social me karakter ndërkombëtar. Edhe Shqipëria, në këtë aspekt, nuk ka bërë dhe as nuk bën përjashtim. Periudha e vështirë e tranzicionit u shoqërua me një hemoragji të pandalshme të procesit të emigrimit të popullsisë së vendit tonë, sidomos në drejtim të vendeve perëndimore, në kërkim të kushteve më të jetesës, sigurisë për ...

11

GJIN MARKAJ, DJALI I DUKAGJINIT NË NJU JORK BËN GJITHÇKA TË MUNDUR PËR VËNDLINDJEN

- BIJTË E SHALËS NË MËRGIM PËR TROJET E TYRE -

Historikisht Shala dhe i gjithë Dukagjini kanë qenë një burim i pashterur burrash të zgjuar, mendimtarë dhe strateg përballë të gjitha sfidave dhe rreziqeve që janë kanosur krahinës dhe të gjithë Shqipërisë. Në kohët që po jetojmë shikojmë një shterim të burimit të këtyre virtyteve siç janë ato të dashurisë, mirënjohjes, humanizmit dhe aq më tepër të nacionalizmit të njerëzve në shumë aspekte. Ndoshta është shkaktar fenomeni i kohës së internetit, i cili ndikon sot në këtë shterim. Shumëkush sot nuk po pyet për të afërmit e vet, lanë pastaj për nacionalizmin kombëtar. Ky fenomen përgjithësisht për fat të keq po zgjerohet. Mosmirënjohja thuhet se është institucionalizuar, duke arrit deri në nivelin e papërgjegjshmërisë. Rasti më flagrant është mos përcaktimi prej afro dy vitesh i vendosjes së bustit madhështor të Lekë Dukagjinit, nga pushteti lokal, për këtë vepër djemtë e dukagjinit kanë kontribuar në shuma të mëdha. Por nga ana tjetër, për fat të mirë po ndodh krejt ndryshe me shumë dukagjinas në emigracion dhe kryesisht të atyre në Amerikë. Kontributi me donacionet e tyre individuale dhe kolektive janë një model për tu marrë shembull në të gjithë Shqipërinë. Shumë prej këtyre, ndonëse kanë vetëm pak dekada emigrim, të cilët akoma nuk i kanë ngulur mirë rrënjët e tyre në tokën e premtuar. Zemra ju rreh për vendlindjen duke kontribuar për trojet e veta në mënyrë permanente. Shuma e donacioneve të tyre nuk ka të krahasuar me investimet qeveritare të këtyre 33 viteve për Dukagjinin. Bujaria shaljanë e dukagjinase ka ngritur vepra e monumente, të cilat zënë fill herët, që nga memoriali i Shtatë Shaljanëve dhe në vijimësi, me Mehmet Shpendin, Martin Camajn, truporen e Shna Ndout, memorialin e Martirëve të Kishës, Lekë Dukagjinit dhe me Papa Klementin e XI, ky i fundit nga një djalosh i Gimajve, Ilir Bigaj, lindur e shkolluar në New York. Duhet theksuar se gjatë këtyre viteve asnjë nga politikanët apo deputetët që kanë përfaqësuar këtë zonë nuk shfaqen së paku një ide për të realizuar ndonjë vepër, përveç premtimeve absurde në fushata të shpifura elektorale.

Është detyrim njerëzor dhe mirënjohje të dëshmosh duke shkruar për këto figura të njohura, por edhe të panjohur më parë, të cilët po kontribuojnë për komunitetin nga i cili kanë dalë, megjithëse i ndajnë dete dhe oqeanë e mendja ju punon për vendlindjen. Janë njerëz që bëjnë emrin e tyre të përveshëm, janë bij të atyre familjeve të fisshme që nuk ndihen rehat pa kontribuar për trojet e veta. Të surprizon

fakti se ka prej atyre që kanë lindur përtej Atlantikut, të cilët duke krijuar shoqata, mbledhin donacione edhe nga të huajt si kompani, bashkësi e të huajve në New York, për të kontribuar për ndërtimin e kishave, urave, monumenteve, memorialë, buste, rrugë, ujësjellësit dhe vepra të ndryshme social kulturore. Një kontribut i jashtëzakonshëm u dha me rastin e pandemisë, duke sensibilizuar jo vetëm shqiptarët, por edhe shtetas të tjerë në Amerikë. Për rrjedhojë është një nderim i veçantë jo vetëm për dukagjinasi, por për të gjithë shqiptarët përshëndetja e Papa Françeskut drejtuar me rastin e përrimit të këtyre veprave madhore.


Përveç këtyre kontributorëve të këto vepra, duhet shënuar edhe kontributi i shumë personave biznesmen dhe njerëz të thjeshtë shaljanë, dukagjinas në jetën kulturore dhe artistike, duke organizuar në mënyrë të vijueshme festivale muzikore, koncerte madje edhe jashtë vendit, po kështu studiues e publicist, shkrimtarë e botues, nëpërmes pendës së tyre bëjnë Dukagjinin të njohur kudo. Ka prej atyre intelektualëve që krijimtarinë e tyre si klipe apo dokumentarë i kanë sponsorizuar nga buxhetet e tyre, kjo është një risi që këta krijues, intelektual të jenë edhe mundësor financiar të veprimtarive.

Shoqata Atdhetare "Dukagjini" mbi 20 vjeçare me gazetën e saj, është e vetmja në Shqipëri e drejtuar nga një pasionant, i cili duhet vlerësuar dhe përshëndetur.

ECURIA E DJALOSHIT GJIN MARKAJ, I CILI KËRKOI VETËM PROGRES

Gjin Markaj i lindur me datë 29 qershor 1966, në Vuksanaj të Shalës. Djali i Marash Markaj, një burrë malësor tek i cili spikatën veti e virtyte burrërore. Ndërsa nëna Bardhe e bija e Zef Babunit nga Nikajt, dalë nga një derë e sojshme tek e cila spikatën disa cilësi të veçanta që e karakterizuan gruan dukagjinase. Përballë kushteve tejet të vështira ekonomike, siç ishin për çdo grua të asaj kohe, ajo mbi gjithçka pati kujdesin për mirëritjen e fëmijëve të saj dhe në veçanti për edukimin e shkollimin e tyre. Gjini një fëmijë i zgjuar dhe energjik e shumë i dashur me bashkëmohatarët e vet mbaroi shkollën 8-vjeçare të Ura e Re. Më pas vijoi shkollën e Mesme Bujqësore në Breg të Lumit,

e cila përbëhej nga një grup arsimor kualitativ, duke qenë i vlerësuar jo vetëm në rrethin e Shkodrës, por në të gjithë veriu. Duhet theksuar se shumë nga ky grup mësimor, më vonë do ti gjenim në detyra të larta shoqërore dhe shtetërore. I kemi studiues, shkencëtar, deputet, kryebashkiak e të tjera. Niveli i nxënësve të kësaj shkolle, për shumë vite ishte model, duke u krahasuar me shkollat në nivel rrethi dhe kombëtar. Mjafton të përmendim faktin



se nga këta ish nxënës i kemi në drejtim të institucioneve të ndryshme shtetërore deri në drejtimin e Portit të Durrësit, disa mjek që kontributin e tyre me vlerë e tregojnë duke drejtuar edhe spitale në Evropë dhe Amerikë, të cilët ndihmojnë për vendlindjen. Nga kjo shkollë dolën biznesmenë të njohur për kontributin e tyre nga vendlindja deri përtej Atlantikut, të cilët financojnë në mënyrë të vazhdueshme. Nga këto banka gjithashtu kanë dalë edhe sportistë të talentuar deri në nivelin nënkampion bote. Ju kërkoj ndjesë, sepse e kam të pamundur të përmend emrat e përveshëm të këtij kolektivi të nderuar mësues e nxënës, për arsye se lista është e gjatë, kjo më rezultoi nga një studim të cilin e kam ende të papërfunduar. Njëri nga nxënësit e spikatur të kësaj shkolle është personazhi i shkrimit tonë, djaloshi z. Gjin Markaj, i cili mbaron maturën në vitin 1983. Nisur nga rezultatet e larta vazhdon Fakultetin e Agronomisë në Tiranë, të cilin e mbaron në vitin

1988. Duke u rritur e ushqyer nga ndjenja antiregjim i sistemit, ky qysh në vegjëli shoqëronte të atin teksa ndiqte fshehurazi radiostacionet e Radio Vatikanit dhe Zëri i Amerikës, u mishërua me pjekurinë e tij. Për rrjedhojë vetëm pak ditë pas mbarimit të studimeve, në atë gusht përvëlues të vitit 1988 do të provonte së bashku me shokun e tij, Kolë Tonaj (më pas deputet), birucat e sigurimit të shtetit nga Tropoja në Shkodër, për tentativë arratisje. Filimet e punës si agronom i pati në Theth.

Në vitin 1991, Gjin Markajn e gjejmë të parin kryetar të Këshillit Pluralist në Shalë. Duke marrë shkas nga përkushtimi dhe devotshmëria, Gjini ngjiti shkallët e karrierës me shpejtësi të pamatur. Në fundvitin e 1992-it caktohet shef i policisë së objekteve në Komisarariatit të Policisë në Shkodër, pas pak kohe kalon në Policinë Gjyqësore në rolin e shefit të Policisë Kriminale. Pas pak kohe komandohet shef i Komisarariatit të Policisë në Shkodër. Vitin 1995 e fillon me detyrën e shefit të Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë Ushtarake Shkodër, për rajonin e Veriut. Gjini kalon në poste të ndryshme të organeve ligjzbatuese dhe më pas dërgohet për specializim për Policinë e Shtetit në Florida, SHBA.

Në vitin 1996 ka përfunduar Fakultetin Juridik. Pas pesë vitesh largohet fizikisht nga Shqipëria për në New York, por jo me mendje dhe

me zemër, kjo i shkon për shtat një thënie e poetit Mhill Marku, djali i Dukagjinit 6 dekada më parë në librin "Mall e Vaj" për vendlindjen ku shkruante: "Ah sa mall / E sa kujtime / Për ty ndej, / O Shala ime / Mall për lisat, / Mall për Pishat, / Mall' ah, mall dhe për bishat!"

Çdo punë e suksesshme kërkon edhe bashkëpunëtorë. Një shprehje e urtë thotë: "Pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua". Po, pas z. Gjin Markaj kush qëndron? Patjetër një zonjë e lindur nga një familje shkodrane në brezni e nderuar. Do të ishte e pamundur që tek burrat e Shalës, si zotëritë Gjin Markaj, Vatë, Ilir e Gjovalin Biga, Dedë Prendaj, Ndreka Tonaj, Dedë Tonaj, Nush Noli e shumë të tjerë të kontribuonin në këto përmasa pa mbështetjen dhe shtysën e bashkëshortëve të tyre fisnike dhe të nderuara.

z. Gjin nga etja për ngritjen e tij profesionale licencohet për menaxhim e mbrojtje të ndërtesave komerciale kundra zjar-

rit. Sot ushtron veprimtarinë e biznesit privat menaxher në ndërtimin mirëmbajtjen në Manhattan, New York.

KONTRIBUTI PËR VENDLINDJEN

Sapo fillon epidemia e koronavirusit, ky ishte promotori i bashkimit të shumë Dukagjinave në New York, në zyrën e biznesit të shaljanit tjetër z. Dedë Prendaj ku krijuan grupin nismëtar "Shaljanët në SHBA për trojet e tyre", duke mbledhur ndihma për 600 familjet më në nevojë me banim në Dukagjin dhe rrethina të Shkodrës, si medikamente, ndihma ushqimore, veshmbathje dhe vlera monetare. Në vitin 2021 "Bashkësia e Dukagjinit" nën drejtimin e Gjin Markajt në Shalë u krijua komisioni i infrastrukturës. Falë kontributit të këtyre biznesmenëve, njerëzve të thjeshtë dhe disa donatorëve të huaj në Amerikë, me donacionet e tyre u riparuan shtëpi, ujësjellsa dhe objekte të tjera, kisha, buste, memoriale, ura, rrugë e vepra të tjera socialkulturore.

Me kontributin e tij dhe familjes së tij u rikonstruktua Ura e Shalës dhe financoi me shuma të konsiderueshme edhe në vepra të tjera për Urën e Telit në Breg-Lumit, Ura e fshatit Marrnikaj në Breg-Lumit, Ura e Re në Lotaj, Ura e Re në Nicaj-Shalë, Ura e Xhaferajve në Gimaj, Ura e Shkafjes, Ura e Bjeshkë Preles, që lidh Breg-Lumin me Urën e Re Lotaj. Në vitin 2022 përfundoi kisha e Gimajve me financimin e shoqatës "Bajraktari" në New York, SHBA nga Vatë Ilir e Gjovalin Biga. U vendos Truporja e Shna Ndout tek Ura e Shalës me kontributin e familjes së z. Gjin Markaj, ndërsa sheshi i tij u financua nga z. Nush Noli, emigrant nga Thethi me banim në SHBA.

Në vitin 2023 vendoset Memoriali i T' lumnumeve të Kishës në oborrin e Kishës Shën Shtjefni në Breglumit, kryesisht me kontributin e biznesmenit, z. Dedë Prendaj Shoqata "Shaljanët në SHBA për trojet e tyre" tani emërtohet "Dukagjinat në emigrim për trojet e veta", duke krijuar degë në çdo vend të botës. Jemi të bindur se ky kontribut do të ketë një rritje të konsiderueshme.

Teksa po përfundoj shkrimin informohem se z. Gjin Markaj si njeri i etur për dije nuk ka të ndalur në formimin dhe shkollimin e tij. Më shkon në mendje një personalitet i shquar shqiptar Fan Noli, po në Amerikë i cili ndonëse në moshë të thyer mbronte doktoraturën në Konservatorin e Muzikës në "Harvard". Ndërsa z. Gjin sot ia lejon moshën të vendosë rekorde të reja. Ky sapo mbaroi me sukses Institutin për Diplomaci të të Drejtave të Njeriut në Washington Dc, mundësuar nga kompania DE MAMION, ku ai punon prej 16 vitesh. Me këto rritje dhe kontribute për vendlindjen, është nderi i madh për Shalën, Dukagjinin dhe gjithë Shqipërinë. Por ana e padukshme e z. Gjin Markaj si donator dhe njeri human është disi e veçantë, e cila i shton vlerat. Marrim një fakt tepër mbresëlënës. Një libër i Shenjtë shumëshkollor i shpëtuar nga djegia e një kishë të Pensilvanisë ku ai qëndronte prej 111 vjetëve doli në ankand nga ky shtet për të siguruar fonde për rindërtimin e kësaj kishë. Këtë libër z. Gjin ia dhuroi Imzot Massafres, dhuratë për kishën. Natyrshëm secilin prej nesh do ta shtynte kurioziteti të dijë çmimin e këtij libri? Unë kam në dorë një botim,

në të cilin regjistrohen të gjithë personat vendas dhe nga çdo vend i botës që kanë kontribuar dhe vlerat që kanë dhuruar për këto vepra në zonën e Shalës, por nuk kam arritur të përcaktoj shumën e dhënë nga z. Gjin Markaj. Jo më të përcaktoj vlerën e këtij libri të Shenjtë. Por për një gjë jam i sigurt, se vetëm ai që i ka dhanë këtë dhunti ka dijeni për çdo qindarkë të dhuruar prej tij.

Ne, si dashamirës të tij dhe i gjithë Dukagjini duhet ti urojmë çdo të mirë në jetë me familjen e tij, për kontributin e dhënë për të gjithë Dukagjinin dhe duke i uruar suksese në punën e përditshme.

ANA JONJERËZORE E DISA INDIVIDËVE TË VECANTË

Për gjithçka cituam më sipër për këto kontribute të tyre, të gjithë duhet të ndihemi mirë dhe krenar si dukagjinat dhe duhet ta vlerësojmë sakrificën, mundin dhe djersën e derdhur. Por natyrshëm lind pyetja:

A jemi të gjithë në vlerësimin pozitiv të këtij kontributi? Fatkeqësisht jo. Ka individë jo të pakët në numër, të cilët mundohen në mënyra të ndryshme të denigrojnë dhe të vjellin vrerë për të demotivuar këta

paratë. Apo filani do të ishte më mirë të bënte këtë, apo atë sesa të ndërtonte buste, ura e memorialë e të tjera e të tjera. Ka individë të kësaj kategorie ekzemplare, të cilët mundohen të denigrojnë figurat e intelektualëve të njohur si dr. shkencash, profesor, botues, publicist dhe shkrimtar, që kanë botuar mbi 20 libra dhe vepra letrare, duke qenë njëkohësisht edhe drejtues në bordin e shkrimtarëve. Sipas logjikës së këtyre mediokërve, këta nuk na qenkan të aftë të shkruajnë të vërtetën. Kjo kategori, duke pretenduar se janë njohës të historisë dhe të gjithçkaje, por në fakt janë gjysmë analfabetë, ku shpjegimet e tyre janë me bazë farefisnie dhe kulturi bajraktaresk mesjetar. Këta janë megalomanë ndaj të ashtuquajturve barqe sundues. Sipas tyre këto barqe dhe personat e tyre janë të lavdishëm, sepse emrat e tyre janë shkruar në derën e Stambollës. Në qoftë se e marrim të mirëqenë këto thënie groteske atëherë lind pyetja: "Sa na qenka madhësia e kësaj dere?" Atëherë na rezultoi që këta i paskan shërbyer pushtesit pesë-shekullor, çudia tjetër qëndron se në këtë derë nuk kishte vend për emrat e Shtatë Shaljanëve, Babun Celi, Xhur Kola, Qerim Delia e shumë të tjerë që luftuan



persona të njohur si kontributorë.

Dua të eidentoj disa raste. Për një kontributor tashmë të njohur ku me donacionet e tij si pinjoll i një familjeje të njohur ndër breza për mbrojtjen e trojeve, përfaqësues i Shkodrës në takime në Kancelaritë Evropiane dhe Papën, ndërtues kishë në Gimaj dhe jo vetëm, në ura, rrugë, buste, ujësjellsa e shumë vepra të tjera dhe duke qëndruar në ballë të punëve deri në 6 muaj larg familjes së tij, ku me të drejtë Imzot Massafra gjatë përrurimit të Kishës së Gimajve i pat thënë me shaka: "Vatë mirë që jeni shtetas amerikan se, përndryshe do të kishit problem me dokumentet". Marrëzia e mosmirënjohja e tyre jonjerëzore është e pakufishme, gojë e liga të tyre janë shprehur se këto ai i bën për tu dukur, sepse s'ka ku të çojë

hordhitë osmane. Gjithashtu sipas tyre këto barqe janë të sojshme dhe janë të hershme dhe paskan lidhje farefisnore direkte me Murrët apo na qenkan të një barku me Shalën, Shoshën dhe Bukën. Do të ishte mirë që këta "studiuës e historianë" të kursenin pijen e alkoolit me glukozë për shumë vite dhe të dërgonin analizën e tyre gjenetike në universitetin e Harvard, i cili përcakton gjenezën dhe smundshmërinë në kufirin e 2400 vjetëve. Këtë diagnostikim ADN-je e kanë kryer edhe dy intelektual dukagjinat. Sot duhet ecur me hapin e kohës dhe zbulimet e shkencës dhe jo me mentalitetin meskin e anadollak. Një pjesë e tyre nuk kanë as ndjenjë më minimale të humanizmit, ndonëse disa prej tyre mund të kontribuojnë, por nuk tundojnë jo vetëm për të afërmit e

tyre, por as për prindërit me pensionin e tyre në kufijtë e mbijetesës. Komunikimi i tyre në rrjetet sociale, duke përdorur edhe anonimatit është i veçantë, përdorin terma dhe epitete, të cilët nuk ju dinë as kuptimin dhe nuk gjenden në fjalorin e gjuhës shqipe, por leksikografia e tyre gjysmë analfabetike sulmon çdo krijimtari letrare e muzikore, duke mos pasur as njohjen më minimale të këtyre fushave, dhe ende më keq kur këto krijimtari letrare, artistike e muzikore kanë marrë vlerësime nga personalitete të larta të fushave përkatëse dhe kanë pasur shikueshmëri të lartë. Ka edhe prej atyre, të cilët mosmirënjohjen e kanë të mishëruar në zemër dhe në shpirt edhe kundrejt njerëzve të afërm, gjakut apo të besimit duke trilluar pa të drejtë, edhe ndaj atyre të cilët në fëmijëri i kanë përkundur, duke iu kënduar këngët e djepit, dhe sot mundohen ti përçmojnë për punën e tyre të vyer.

Në këto rrethana sot, çdokush që kërkon të bëjë një vepër apo të kontribuojë më parë duhet të mendojë për reagimin e kësaj specie të veçantë. Por një shprehje e një filozofi të famshëm Francez thotë: "Kur flasin budallenjtë, inteligjenca duhet të heshtë". Gjithsesi këta individë të veçantë duhen mishëruar, sepse nuk kuptojnë as vetveten.

Fjala e mbajtur nga z. Gjin Markaj me rastin e përrurimit të trupores së Shna Ndout në Breg-Lumit të Shalës me datë 30 Prill 2022

-Përrshëndetjen time do ta bëj së bashku me z. Nush Noli nga Thethi, kontribuues në ndërtimin e sheshit të trupores së Shna Ndout, të dashur shaljanë e dukagjinat, përfaqësues të kishës e trupit diplomatik, përfaqësues të Prefekturës e Bashkisë Shkodër!

Administratorë të Dukagjinit!

Të nderuar shoqata dhe intelektual e të ftuar nderi!

Falënderoj Zotin e gjithëpushtetshëm, që na ka ushqyer gjithmonë shpirtërisht me besim, dashuri e mirësi dhe shpresë, i cili na ndriçoi mendjen e zemrën, duke na krijuar mundësi për të ndihmuar vendlindjen tonë të dashur, tokën e bekuar të të parëve tanë, të cilët u vendosën para shumë shekujve në Shalë e Dukagjin, tokë që ndër shekuj mbeti e ushquu brezat tone, të cilët e ruajtën nderin, dinjitetin, traditat dhe doket. Sakrifikuan gjithçka në emër të Zotit dhe të Krishtit.

Unë nuk mund të harroj asnjëherë foguret e Krishtit dhe të Zojës së Bekuar dhe të Shenjtëve të tjerë në ndarjet e fshehta të arkës së vjetër të drurit nga babai im Marash Markaj. Këto relike i ruante me kujdes e dashtni së bashku me druajtjen nga unë, vëllezërit e motrat e mia, që mos ti shikonim nga frika se mos na rrëshqiste goja e mund tu tregonim shokëve dhe shoqeve apo ndokujt tjetër, sepse pasojat do të ishin fatale nga rrëgjimi ateist komunist. Nuk mund të harroj kurrë, që të gjitha festat gjithmonë i festonim në shtëpinë tonë. Babai im hiqte kapuçin e bardhë dhe rubën e lidhur rreth tij, hapte dritaret dhe dyert e shtëpisë, duke më dhënë mua qiriun me dyllë bletët si më i vogli i shtëpisë. Dyllin e prodhonte vetë nga ato pak bletë që kishim, e ndiznim dhe e puthnim të gjithë me rrallë, duke thënë uratë me zë të ulët dhe bënte kryq, e puthte duke e vënë në

tërvezen e rrumbullakët prej druri.

Ruaj në kujtesë, kur në orën pesë të pasdites im atë dëgjonte me zë të ulët zërin e Radios së Vatikanit në gjuhën shqipe. Kur binte këmbena ja çonte zërin deri në fund, duke e hap edhe dritaren e dhomës në të cilën e dëgjonte. Ky ishte gëzimi më i madh që përjetonte çdo ditë të javës, të muajve e në vijimësi.

Më rritën dhe më edukuan me vërshtirësitë e pabesueshme të asaj kohe ashtu sikurse të gjithë bashkëmoshatarët e mi në Shalë, Dukagjin e kudo tjetër. Shumë herë i uritur, me rroba dhe këpucë të vjetra e të shqyera në shiun e ftohtë dhe në borën e ngrirë. Interesohesha më shumë për librat në çantën e vjetër të bezes, që te mos me lageshin, duke i mbuluar me trupin tim të njomë.

U largova fizikisht nga vendlindja 21 vite më pare, por asnjëherë nuk u largova me mendje dhe me zemër dhe këto kujtime të fëmijërisë mbeten gjithmonë të pashlyera në kujtesën time.

Gjatë vitit 2020, kur epidemia e virusit izoloi mbarë botën, mendja dhe zemra ime natyrshëm përshtegtoi tek vendlindja ime e largët, tek malet orëçueta të Shalës, tek populli im i vuajtur, besimtar e fisnik i Dukagjinit. Disa prej këtyre familjeve ndoshta ndër ato ditë gjendeshin edhe pa ushqime apo ilaçe. Falënderoj të gjithë miqtë e dashamirësit bashkëvujtës, bashkudhëtar e bashkatdhetarë në mërgim dhe të cilët ju bashkuan nismës sime për të ndihmuar vendlindjen. Ndihamat e para financiare ishin modeste, thjesht vetëm për të ndihmuar e lehtësuar sadopak vuajtjet dhe mjerimin e shkaktuar nga virusi covid-19. Falë Zotit në ditët e sotme bujaria dukagjinase qe shumë më e madhe dhe ndihmat u shumëfishuan kështu që u bë e mundur rikonstruksioni i objekteve të kultit, truporja e Shna Ndout dhe rikonstruksioni i disa rrugëve dhe urave në Shalë të Dukagjinit.

Dukagjinasi në mërgim u bashkuan në New York në zyrën e biznesit të familjes Tonaj, duke lëvdur Krishtin dhe duke tokur gotat e rakisë pa marrë parasysh rregullat ligjore kundër virusit. Mblodhëm ndihmat financiare për dukagjinasi, banorë të Dukagjinit dhe rrethina, ndihma financiare për familje dhe individ me shumë probleme. Falë zotit deri më ditët e sotme mirësia dhe ndihmat financiare

u shtuan dhe u shumëfishuan, duke kontribuar në rikonstruksionin e kishave dhe trupores së Shna Ndout, si simbol i ringjalljes së besimit, paqes e shpresës, projekte infrastrukturore si ura, rrugë, e ujësjellës. Gjej rastin të falënderoj përzemërsisht të gjithë ata emigrantë me punën e djer-sën e tyre të nderhme që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë me ndihma për trojet e tyre, veçanërisht z. Vat Biga me familjen e tij.

Falënderoj përzemërsisht Monsinjon Angelo Massafra dhe Padër Gazmend Tinaj, për pjesëmarrjen në këto ceremoni dhe bekimin e tyre në Shalë, për kontributin e tyre në ringjalljen e besimit fetar, në rindërtimin e objekteve të kultit dhe forcimin e harmonisë fetare. Falënderoj Dom Anton Kodrarin, birin e Shoshit dhe nipin e Shalës, i cili iu përgjigj thirrjes sonë në mbarëvajtjen e këtyre veprimtarive!

Falënderoj komisionin organizator me në krye të palodhurin z. Mark Rupa. Falënderoj djalin e Gimajve të Shalës Gjeneral Perit Çunin, për mundësimin e transportit të trupores së Shna Ndout në Breg-Lumit të Shalës!

Falënderoj administratorët dhe komisionin e ngritur në Dukagjin, për shpërndarjen e ndihmave financiare me korrektësi pa bërë dallime dhe me transparence!

Falënderoj të gjithë ata persona, të cilët fizikisht bënë të mundur realizimin e këtyre projekteve për shalën!

Komisioni "Shaljanët në emigrim për trojet e tyre" u ngrit në kushte të jashtëzakonshme si nevojë emergjente me rastin e covidit dhe funksionoi si i tillë deri në ditët e sotme. Nga ky moment dhe në vijimësi, ky komision do të pagëzohet me emrin fondacioni "Dukagjini në emigrim për trojet e veta". Ky komision do të jetë i përhershëm dhe do të funksionojë si i tillë për ndihmat e trojeve të Dukagjinit.

Për Ju Monsinjon Angelo Massafra kam një surprizë të veçantë. Kam një libër të shenjtë qindra vjeçar, i cili ka shërbyer në një kishë në shtetin e Pensilvanisë, kishë e cila u dogj, por mrekullisht shpëtoi kjo Bibël, një kryq dhe fogurja e Krishtit. Kjo Bibël shërbeu në këtë kishë plot 111 vjet, e cila më pas u vu në ankand nga ky shtet për të siguruar fonde për rindërtimin e kishës, e cila u dogj. Sot kam rastin për t'ua dhuruar Ju Imzot Massafra,

me motivacionin "Për pjesëmarrjen, bekimin dhe drejtimin e ceremonive fetare në Shalë, për kontributin tuaj në ringjalljen dhe ringritjen e besimit fetar në Dukagjin, Shkodër e gjithë Shqipërinë". Zoti e bekoftë Shalën, Dukagjinin dhe Kishën.

Gjithashtu nga Selia e Shenjtë në Vatikan kemi një surprizë të veçantë: Ati i Shenjtë ka bekuar Shalën ditën e sotme dhe e ka dërguar nga Selia e Shenjtë urimin për Shalën dhe Dukagjinin "ATI I SHENJTË FRANCESKU I JEP PËRZEMËRSISHT BEKIMIN APOSTOLIK, DJALË DUKAGJINI ME RASTIN E DITËLINDJES SË TIJ DUKE THIRRUR ME NDËRMJETËSIMIN E BEKUAR VIRGJËRESHËS MARI, NJË BOLLËK HIRESH HYJNORË"

Të nderuar pjesëmarrës surprizat vijojnë. Me rastin e përrurimit të Kishës së Gimajve dhe trupores së Shna Ndout, kemi një dhuratë nga z. Pjeter Ndosh Bari, mesharin e ruajtur me aq kujdes, në fshehtësi absolute pa marrë parasysh edhe pasojat, qysh nga viti 1948 në Gimaj të Shalës.

Përhëndetja e z. Gjin Markaj me datën 26 Shtator 2023, me rastin e përrurimit të Memorialit të Martirëve të Kishës në Breg-Lumit, Dukagjin

Të dashur vëllezër e motra dukagjinasi, të nderuar familjarë dhe të afërm të Martirëve!

I nderuar Angelo Massafra!
i nderuar z. Benet Beci, kryetar i Bashkisë Shkodër!

Sot është një ndër ditët më të bukura të jetës sime. Në këtë kishë për të përkujtuar jetën dhe veprën e atyre që nuk kursyen as jetën si gjënë më të shtrenjtë, në emër të besimit në Zot ndërruan jetë me ideale të pavdekshme, por me dëshira të parealizuar.

Falënderimi i parë efshte për Zotin e Gjithëpushtetshëm, që na krijoi këtë mundësi për të bashkuar dhe për të kujtuar nderimin e tyre, duke ngritur këtë memorial në oborrin e kësaj Kishë në emër të Martirit të parë pas vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit, Shën Shtjefnit.

Falënderoj përzemërsisht Monsinjon Massafren për kontributin dhe pjesëmarrjen në Meshën dhe inaugurimin e bekimin e këtij memoriali si dhe bekimin e Bekimit Apostolik të ardhur nga Selia e

Shenjtë e vendosur në sheshin e trupores së Shna Ndout. Gjithashtu falënderim të veçantë për Angelo Massafren për të gjitha kontributet e tij që ka dhënë në Shqipëri për ngritjen, ringjalljen e forcimin e besimit fetar dhe të Kishës Shqiptare!

Falënderoj komisionin organizativ të koordinimit të kësaj veprimtarie me kryetar z. Mark Rupaj!

Një falënderim krejt i veçantë është për mjeshterin e gurit, skulptorin e talentuar burrin e Shoshit z. Zef Muri, i cili me përkushtim, fantazi dhe mjeshtëri të rrallë realizoi në gurë këtë vepër gjigande, të cilën mund ta quaj unikale në llojin e vet, e cila do të mbetet e pavdekshme si madhështia e maleve tona! Falënderoj burrin e Gimajve të Shalës, mjeshterin Ndue Staka D'dhinishta, i cili ideoi, projekttoi dhe zbatoi këtë Projekt!

Falënderoj biznesmenin z. Dedë Lucaj, që kontribuoi financiarisht në ceremoninë e këtij memoriali! Falënderoj burrin e Shoshit, publicistin, shkrimtarin dhe studiuesin z. Prel Milani, një nga ideatorët e kësaj veprë!

Falënderoj z. Bënte Beci, Kryetar i Bashkisë Shkodër, për pjesëmarrjen në këtë veprimtari, i cili ndihmoi edhe në përmirësimin e infrastrukturës së rrugës nga Ndërlysa në Breg-Lumit, për ta bërë sa më të lehtë lëvizjen e automjeteve për këtë veprimtari, në të njëjtën kohë e falënderoj edhe për mundësimin e fillimit të punimeve të rrugës Prekal-Kir, si një ëndërr shekullore e Dukagjinasi!

Falënderoj të gjithë ata që kontribuuan në rregullimin e ambienteve të jashtme dhe të brendshme të kësaj kishë!

Falënderoj gjithashtu burrin e Shalës Dr. Mark Bobnaj dhe Gëzim Çuni, të cilët kontribuuan financiarisht për rikonstruksionin dhe rregullimin e ambienteve të kësaj kishë!

Falënderoj të gjithë juve që u përkushtuat dhe sakrifikuat për të marrë pjesë në këtë ceremoni!

I përjetshëm qoftë vepra e shenjtë dhe kontributi i Martirëve të Dukagjinit dhe të gjithë Shqipërisë! Kjoftë i bekuar dhe kurrë mos u harroftë gjaku i Martirëve si forca e Krishterimit!

Përgatitur nga Mark Bobnaj

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT, DISKUTIM PUBLIK NË SHKODËR

Në kuadrin e nismës "Jo Korrupsionit, Po Demokracisë" dhe me mbështetjen e qeverisë së Suedisë, Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi në Shkodër, më datën 13 shkurt 2024 diskutimin publik me temë "Roli i institucioneve në luftën

kundër korrupsionit, misioni, veprimtaria dhe bashkëpunimi me qytetarët". Ishin të pranishëm aktivistë të të drejtave të njeriut të shoqërisë civile dhe të medias në qytetin e Shkodrës.

Nën moderimin e Lutfi Dervishit, lek-

tor pranë Departamentit të Gazetarisë në UT dhe anëtar i Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Fjalën e mirëseardhjes e mbajtur Ardita Kolmarku, Drejtore e Klinikës së Ligjit dhe menaxhere projekteve pranë kësaj organizate.

Duke hyrë në brendësi të kësaj teme kanë diskutuar, por edhe bashkëbiseduar me të pranishmit Koco Sokoli, kryeaudituës në departamentin juridik pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). Po kështu edhe Majlinda Thoma dhe Ornella Zguri, inspektore në Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI).

Ka diskutuar dhe bashkëbiseduar me të pranishmit edhe Florian Demollari, drejtues i përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Njësisë Antikorrupsion pranë Ministrisë së Shtetit për Admin-

istratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Diskutimi ka vijuar edhe me organizatat e shoqërisë civile në Shkodër ku kanë folur Marjan Lukani, drejtues i Qendrës Rinore Arka, Peter Saraci, pedagog në Universitetin "Luigj Gurraquqi" dhe Erdion Macolli Avokat në Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Këtu ka pasur mjaft diskutime sepse të pranishmit folën jo vetëm në përgjithësi por edhe për raste konkrete dhe flagrante të shkeljes së të drejtave të njeriut në Shkodër

Vlen të përmendet fakti se Suedia shpenzon rreth një për qind të GDP-së në vit ndihmë financiare për projekte të ndryshme me fokus të drejtave të njeriut në vende të ndryshme të botës. Kjo është shifra më e lartë financiare në raport me popullsinë që një shtet me demokraci të konsoliduar investon jashtë për këtë qëllim.

ARBEN LAGRETA



I SHKRETI...

Mu kujtua një shprehje që unë e kisha dëgjuar mbi gjysëm shekulli më parë. Mbase më nxiti mendimet ndonjë veprimtari dhe qëndrime në shkrime të ndryshme të shtypit, pse jo edhe botime librash.

“Nuk dua që të më thonë gjithkush ‘i shkreti’, dua që dikush edhe të me thonë ‘mirë e ka qeni’, sepse kjo më jap zemër, më shtojnë inatin për më mirë, për të mos u dorëzuar lehte, për tu ngritur, për të mos u rrëzuar”, pata dëgjuar një herë gjyshin tim në atë kohë.

“I shkreti malësor”, “i shkreti fshatar”, “i shkreti”, “fukarai”, “i padituri”, “injananti”, “i trashi”, “i varfëri”, “naivi”, e të tjera, të kësaj natyre janë përdorur, por edhe po përdoren sa herë që një kalemxhiu i duhet që të shkruaj diçka për këto zona, dhe këta banorë, dhe kjo më shumë se sa për të treguar dhimbjen, për tu dukur i vëmendshëm, i shqetësuar, për tu dukur se jeton me këto vështirësi, me këto krahina, me këto zona, me këta banorë. Të tillë kalemxhinj i paraqesin banorët si simbol i viktimës, të përbuzur, të pafuqishëm, por kur i duhen, madje pikërisht shumë nga këta, i paraqesin edhe si heronj, trima, të vendosur, reformator, të fuqishëm, bujar, atje hahet mirë, jetohet mirë, ka mjedis të pastër. Është karakteristikë e malësorit që të flasë shkurt, shpejt dhe qartë. Kështu është formuar gjatë kohës, sepse nuk ka pasur shumë kohë dhe mundësi, për vetë kushtet ekonomiko-shoqërore dhe natyrore, që të bisedojë ngeshëm, të shpenzojë shumë kohë, prandaj flet hapur, dhe me fjalë të thjeshta, të cilat i merren, shpesh, ose si ta kërkojë nevoja, si naivitete, madje edhe nga ata që “e kanë për zemër” malësorin. Jo zotrinjë, fshatari, malësori nuk është aq i prapambetur sa e mendojnë këta, por ndokujt i duken si të tillë nga sinqeriteti i tyre. Malësori është, disi i vonuar, sepse kështu ju krijuan kushtet, për jetesë, për shkollim, për kulturë, dhe për këtë nuk përjashtohen as ata që “përgjërohen” për malësorët, e që i kanë si “fishek afër



vajnicës” sa herë ju duhen portrete, figura, personazhe, luftëtarë, viktima, të përlulur, të përbuzur. Mirë, se, të tillë ka kudo, por kur shikohen përdorime me vend dhe pa vend të këtyre figurave në piktura, letërsi artistike, fotografi, studime, e të tjera, nuk shikohet dhe nuk ka ngrohtësi brenda tyre.

Po realizohen botime jo të pakta ku paraqitet jeta dhe mënyra e jetesës së

banorëve të zonave rurale, dhe kjo, është pozitive, por kur shikohen denigrime, zhveshje nga virtytet e veta dhe veshja e të tjerave, vendosja e negatives në qendër të vëmendjes, vendosja e ngjarjeve të huazuara nga zona, krahina apo fshatra të tjera, me qëllim për tu paraqitur si më i fuqishme përpara lexuesit nuk ndikojnë për mirë. Po ndodhë që vetë ata që dikur shkruanin me aq pasion, me aq frymëzim, me aq pompozitet, po përsëritin vetveten, por tash me drejtim të kundërt, tash me ngarkesa negative. Një herë bëhen lavdërime, ngrihen himne, e më vonë, për të njëjtën ngjarje apo person, bëhen kritika dhe denigrime, në vartësi të situatave politiko shoqërore. Edhe kjo mund të bëhet, por nuk është se tregon ndonjë gjë me rëndësi. Në jetën e përditshme takohen raste apo persona që paraqiten here si viktimize dhe here si heronj, kërkojnë ndihmë për çdo gjë e vazhdimisht; “ma jep atë”, “më sill këtë”, “ma jep dorën”, “bëje punën kështu, apo ashtu”, “jo lart e poshtë, por, poshtë e lart”, “shtyju më tej”, “eja më kënde”, dhe madje kërkojnë që të zbatohen mendimet e tyre pa thënë “pse”, pra në një kuptim kërkojnë gati “skllever” në punë e në mendime, e madje nga “sklleverit” e mendimeve duhet pasur shumë kujdes. Natyrisht është e drejtë e tyre, por kohët kanë ndryshuar, dhe lexuesit e dëgjuesit kanë të drejtën e tyre për të njohur, menduar, folur dhe reflektuar.

Ka edhe nga ata që thonë, madje trumbetojnë së kjo zonë, apo ajo tjetra, duhet të ruhet nga ndikimet e bashkohores, të ruhen ndërtimet ashtu siç kanë qenë dikur, të ruhet ajo mënyrë jetese, madje edhe ato marrëdhënie shoqërore, kjo e fundit nuk thuhet fort hapur por kur na u deshka që të jetohet si dikur, atëherë edhe marrëdhëniet shoqërore duhet të jenë të tilla. Por a mund të realizohet një gjë e tillë, sot, që zhvillimi në shkallë botërore ka arritur nivele të pa imagjinuara. E gjithë kjo mendohet dhe trumbetohet që ti shërbejnë turizmit, të tjerëve, që të kënaqen me trashëgiminë tonë, të shikojnë se si kanë jetuar të parët e tyre, por që sot nuk i kanë atje, dhe as që duan ti restaurojnë, e as ti muzealizojnë, por i duan këtu. Ka pasur raste, që kemi

dëgjuar, hapur, të jenë shprehur, se nuk duhet të përmirësohet rruga e makinës, të mos shtrohet më asfalt, e të tjera. Sepse kështu e duan ata që duan të lëvizin me motorra, në këmbë apo me makina malore, e të tjera, e të tjera. Kjo e fundit është shprehur edhe nga shqiptar, madje edhe ndonjë banorë i zonave, apo qytetas, jo shumë kohë më parë.

Po për kë punojmë, për kë ndërtojmë, për kë kërkojmë përparimin, për veton tonë e fëmijët tonë apo që tju bëjmë qejfin të tjerëve, qofshin këta turist, aventurier të ecjeve malore, e të tjera. Ne duhet të ndërtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, në përshtatje me kushtet, duke ruajtur traditën maksimalisht, duhet të ruhen ushqimet natyrore tradicionale, por natyrisht nuk mund të sërvioren në bluda prej druri dhe të hanë me lugë prej druri, në mënyrë kolektive, në terveza dhe të ulur në fier apo kashtë mistri. Koha ecën dhe nuk kthehet prapa. Duke menduar mbi këto, që u thanë këtu, atëherë çfarë mund të kumtojë shprehja; “është i mirë i shkreti”, përveç se afërsisht; “po të them një rrënë të saktë, ti je burrë i mirë!”

Të tilla mendime, apo vlerësime bëhen, me sa duket, duke menduar se atje, në ato male, në ato fusha, në ato zona, gjithçka thuhet në qytet duhet të pranohet. Vërtetë kultura hyn e del përmes derës së qytetit, por kudo ku jetojnë njerëz ka kulturë, ka traditë, ka norma e tradita që janë krijuar në një kohë shumë të gjatë, dhe këto duhet parë e vlerësuar në kohën dhe hapsirën e tyre. Mbase ka shumë raste që historia dhe kultura ose elemente të tyre, janë më të thella në histori në zona rurale, qofshin këto zona malore apo fushore, se sa në shumë qendra urbane, prandaj nuk ka se si të mos vlerësohen e vendoset ku e meriton.

Mëshira, ndihmat humanitare, lëmosha, dhurimet, vlejnjë për momentin, por, nuk të qesin në anë. Njerëzit duan punë, vlerësim, drejtësi, hapësirë, që të përmirësojnë vetë jetën e tyre.

Luigj Shyti



Adoleshentët në kërkim të motiveve të reja

Shkruar nga Fran Gjoka

Jeta në shkollat shqiptare rrjedh dhe gjallëron përditë. Krahas përkushtimit të drejtuesve, mësuesve dhe nxënësve për zbatimin e programeve dhe përvetësimin e dijeve, herë-herë ndodh diçka që qortohet nga mësuesit. Disa nga adoleshe ntët vijnë të papërgatitur në mësim, të tjerë kanë ardhur pa bërë detyrat ose kanë "haruar" fletoret në shtëpi, dikush nuk është i vëmendshëm dhe gjatë orës së mësimi hedh vështrimin ëndërrimtar nga dritarja, dikush godet me një shuk letre shokun në krah të tij, një tjetër shkarravit mbi tavolinë emrin e sportistit apo këngëtarit të famshëm që ka për zemër etj. Pas mësimi këta nxënës adoleshentë, gjithnjë të zhurmshëm dhe të hareshëm, duan edhe të luajnë pakëz, të argëtohen, të bëjnë edhe ndonjë shaka, të tregojnë një anekdotë. Por, diku ndodh edhe ndonjë grindje apo sherr i mprehtë, një zënkë që nis si me shaka dhe shndërron padashur në një konflikt të rëndë dhe të rrezikshëm. Madje ndonjëri nga jashtë oborrit të shkollës, kërkon të bëjë fortin, ai dëshiron të dallohet nga të tjerët, të shfaqet origjinal në fjalët dhe në veprimet e tij. Ai kërkon të zbulojë rrugët që i duken të drejta për të qenë sa më interesant në jetë, të tërheqë vëmendjen e të tjerëve drejt tij.

Pa këto zhurma të hareshme nuk mund të kuptohet dot jeta e adoleshentëve. Nëse do t'i kthehemi realiteteve të shkollës, pas emrit të çdo nxënësi, pas numrit rendor në regjistër, pas çdo note, është një nxënës adoleshentë me botën e tij shpirtërore në formim, i brishtë, që ka nevojë të orientohet, të nxitet e të mësojë, paçka se ai për veten e tij thotë se "i di të gjitha dhe s'ka asgjë për të mësuar". Por ai ndihet keq kur ndien indiferentizëm ndaj tij, kur nuk e përfillin dhe nuk tregojnë interes për të. Ai ndihet keq kur nuk di se ç'të bëjë, kur nuk ka motive në jetë. Në kësi rastesh për adoleshentët, një ditë nuk ndryshon nga një ditë tjetër, një muaj nuk ndryshon nga një muaj tjetër: "Ah, gjithnjë të njëjtat gjëra! Sa e mërzitshme është kjo jetë!"

Nxënësit adoleshentë fillojnë e bëhen melankolikë, mbyllen në vetvete, bien në pesimizëm e gjer në dëshpërim të thellë. Dhe ky është çasti më i rrezikshëm, sepse ata përpriqen të gjejnë ngushëllim dhe zgjidhje, duke hedhur vështrimin nga rruga, që i tërheq si "gjarpër i keq".

Lexo po deshe hartimet e çiltra të disa prej këtyre adoleshentëve. Aty ata rrëfehen, aty shprehin diçka nga zjarri i shqetësimeve që i djeg përbrenda shpirtit, aty sheh se si ata përpriqen e përpëliten pa mundur të gjejnë gjithnjë rrugët më të drejta të jetës.

SHKOLLA, JO VETË PARANDALON TË KEQEN, POR AJO EDUKON DHE MOTIVON JETËN E NXËNËSVE TË SAJ

Nuk them se këta adoleshentë duhet të mbahen për dore. Jo. Këtë ata nuk e pranojnë, ndihen të fyer, por gjithsesi, ata duhen orientuar, duhen ndihmuar të kapërcejnë gjendjen stresante dhe të rënduar psikologjike. Ata duhen shkundur, duhen

vënë në lëvizje, duhen hedhur në veprim. Në shkollë është vendi ku duhet të edukohen ndjenja dhe të nxiten ëndrra të bukura, është vend ku hedh shtat personaliteti i adoleshentit, ku ai orientohet drejt së bukurës dhe së mirës, së drejtës dhe progresives. Shkolla ka rolin e saj të padiskutueshëm dhe parësor në ndryshimin e gjendjeve dhe përsosjen e realitetit ku jetojmë. Është forca e arsimit dhe e kulturës që shpërndan mjegullën dhe errësirën, prapambetjen dhe injorancën, që i kundërvihet së keqes dhe ligësisë, që mbron të drejtat e adoleshentëve nga dhuna dhe arbitrariteti... Duke u ndodhur përballë vështirësive, duke ngritur nivelin e punës së saj, shkolla të përdorë edhe ajo "armët" e reja të kohës moderne për të qenë e aftë të fitojë mbi sfidat, dukuritë negative, të ndikojë së bashku me shoqërinë dhe shtetin dhe të "ndërhyjë" bashkërisht që t'i shpëtojë adoleshentët nga e keqja, të vihet në krye të veprimeve të fuqishme humanitare. Shkolla s'ka vetëm detyrë t'i qortojë ata, por edhe t'u tregojë atyre rrugën e duhur, rrugën e dijës dhe të zhvillimit, t'u tregojë se "jeta nuk është fushë me lule", por se ajo që në dukje shfaqet si një "lumë i qetë", në fakt është një "lumë i rrëmbyeshëm", i cili përballohet duke e mësuar mirë notin, duke u orientuar, duke iu shmangur vërshimeve që të rrëmbejnë, "gjeratoreve" që të përthithin brenda tyre...

TALENTI NUK ZHVILLOHET VETVETIU

E përbashkët është se, të gjithë kemi qenë dikur nxënës dhe si të tillë nëpër vite bëjmë vlerësime dhe shfaqim opinione për mësuesit tanë. Ata qëndrojnë në mendimet dhe përfytyrimet tona si njerëz të afërt, kujtimet për ta na bëjnë që të ndjehemi mirë, na bëjnë që të na vërshojnë emocione dhe mbresa të shumta, teksa malli dhe buzagazi na rrëshqet ëmbël në fytyrat dhe në sytë tanë. Nuk e di pse ndodh kjo me mësuesit? Mbase, sepse të gjithë kemi marrë diçka prej tyre në formimin tonë, në shprehitë dhe zakonet tona, diçka që fillon që nga mënyra se si përhëndetemi, sesi respektojmë dhe duam njëri-tjetrin dhe jetën, nga mënyra se si nisim dhe zhvillojmë një bisedë si zgjidhim një problem, si futemi në botën e mrekullueshme dhe të mistershme të dijës...

Janë mësuesit të parët që kapin prirjet e nxënësve dhe kujdesen vazhdimisht që ato të nxiten dhe të zhvillohen më tej. Se talenti nuk zhvillohet vetvetiu, por kërkon një mjedis përkrahës ashtu si fara, e cila që të shndërrohet në bimë, kërkon kushte të caktuara klimateriko-tokësore, kërkon shërbim, ngrohtësi e përkujdesje.

Të vihen në lëvizje energjitë krijuese të adoleshentëve

Jo vetëm muaji i letërsisë, por edhe çdo orë tjetër e mësimi duhet të bëhen nxitje për ata nxënës, të cilët shfaqin prirje dhe ide krijuese. Të vihen në lëvizje energjitë krijuese të adoleshentëve. Ato ekzistojnë, janë të fshehura dhe të struktura brenda tyre, ato duhet të zgjohen, të vihen në lëvizje, të trokitet në to: "-Hej, djalosh, zgjohu! Mos

fli gjumë! Jeta është e bukur, shiko, hap sytë, hidhu edhe ti në vrullet dhe dallgët e jetës, lëviz, përpriq, mundohu, përlëshu me të keqen, kapërce majën dhe ec përpara, vazhdo ngjitjen, ke maja të tjera përpara për të kaluar. Tek përballimi i këtyre vështirësive, te kapërcimi i tyre qëndron bukuria e jetës. Kështu, aftësitë, talentet e adoleshentëve nuk kalojnë si hije, pa u ndjerë dhe pa u vënë re, pa mundur të tregojnë aftësitë dhe talentin e tyre... Këtu, mësuesi është kultivuesi, është regjisor i mirë dhe më i talentuar. Janë të shumta fushat ku mund të veprohet, ku mund t'u hapen horizonte adoleshentëve dhe jeta e tyre të motivohet, të marrë vlerë dhe kuptim.

Natyrshisht jo paternalizëm, jo diktim i ideve, por nxitje, krijim i një atmosfere dhe kushteve të përshtatshme që adoleshentët të zgjedhin vetë më të mirën, më interesanten dhe më të bukurën për ta dhe të veprojnë. Atyre nuk mund t'u mohohet zhvillimi i natyrshëm i jetës. Nuk u duhet "vrrarë" fëmijëria dhe rinia, ata duhet ta jetojnë jetën natyrshëm, pa sforco e mundim, nuk duhet t'u diktohet se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë s' duhet të bëjnë, por t'u tregohet e mira dhe e keqja, e bukura dhe e shëmtuara nëpërmjet veprimeve, ndodhive, debateve, ballafaqimeve... Ata duhen nxitur, duhen hedhur në veprim me forcën e fjalës, të ideve, të mendimit të mençur. Në kujtesën e nxënësve mbahet mend mësuesi që i nxit, që u ngjalli besim, që u hapi horizonte të reja për një drejtim të caktuar, zbuloi dhe nxitu pasionin që ata mbanin të fshehur në shpirt e zemër, ata kanë mall dhe respekt, sepse i dedikojnë mësuesit të tyre deri edhe të ardhmen...

Ja sesi shprehet një nxënës për mësuesin e saj të letërsisë: "Te zhvillosh orën e mësimi të letërsisë, do të thotë të udhëtosh në botën e rikrijuar nga ne me petkun e fantazisë. Të fluturosh në lartësitë më të mëdha marramendëse, të jesh i lumtur, të ndjesh freskinë e ujërave të lumenjve, të luleve të bukura, të kapesh realen. Nuk është vetëm një ëndërr, është thjeshtë një orë e nxitur nga mësuesi që shfrytëzon thellësitë e moshës sonë për të na strukturuar në gjirin e letërsisë e në tërë skutat e fshehta të mrekullueshme të saj. Dhe, të gjitha këto, do të doja t'i mblidhja, t'i lidhja në fjongo dhe t'ia dhuroja mësuesit tim".

Dhe në qendër ka qenë dhe mbetet figura e nderuar e mësuesit, e këtij udhërrëfyeti të shkëlqyer të dijës dhe përparimit.

Prandaj dhe mësuesi mbetet gjatë gjithë jetës i fiksuar në mendjen dhe kujtesën e nxënësve.

Me aftësi, takt e durim, mësuesit dinë "t'i marrin" fëmijët dhe nxënësit e tyre ashtu si janë dhe punojnë pa reshtur e pa u lodhur për skalitjen e mendjes së tyre, për pajisjen me dije të thella mbi botën dhe shoqërinë njerëzore.

MËSUESI DHE ROLI I TIJ I PAZËVENDËSUESHËM

Ndaj shkollës jemi të ndjeshëm dhe i detyrohemi të gjithë, prandaj t'i afrohem shkollës, jo vetëm kur na thërret drejtori apo mësuesi kujdestar për fëmijën që është mbetës, rrezikohet të përjashtohet për shkak të mungesave të shumta, por të jemi atje sa herë që shkolla ka probleme dhe gjera për të zgjidhur. Sikurse, drejtorja e shkollës, mësuesit i kanë të gjitha hapësirat e nevojshme që t'u drejtohen hapur dhe pa droje prindërve të nxënësve, specialistëve, njerëzve të artit e të kulturës, biznesmenëve. Ata ndihen të nderuar dhe të obliguar kur drejtorja e shkollës, apo dhe vetë nxënësit i ftojnë për takime dhe bashkëbisedime dhe kërkohet ndihmën e tyre. Duke ndihmuar shkollën, ndihmojmë fëmijët, të sotmen dhe të ardhmen e tyre.

Shumë mësues kanë qenë të suksesshëm sepse me taktin, kulturën pedagogjike dhe horizontin e gjerë kanë arritur të zgjojnë ide, energji, pasione dhe dëshira tek adoleshentët. Ata e kanë bërë këtë duke u treguar të durueshëm e zemërgjerë, duke u qëndruar pranë nxënësve, ashtu si fëmijëve të tyre, duke zbuluar hap pas hapi prirjet e nxënësve, duke i nxitur ata, duke i ndihmuar që të motivojnë jetën e tyre, duke u "mjekuar" gjendjet stresante e, sidomos duke zgjuar te nxënësit adoleshentë shpresa dhe besime të reja për jetën dhe të ardhmen. Mësuesi i mirë ka rastin që me nxënësit adoleshentë, të tregojë edhe ai vetveten, aftësitë dhe përgatitjet e tija, jo vetëm profesionale, por edhe ato pedagogjike, sociale e psikologjike. Ka më shumë vlerë një mësues, që është edhe psikolog e sociolog çdo orë dhe çdo ditë mësimore me nxënësit, sesa disa tema social-psikologjike që programohen herëpashere në planet e drejtorisë apo të mësuesit kujdestar.

Mësuesi i mirë dhe me përgatitje të plotë, është një aset, një vlerë e jashtëzakonshme e shoqërisë, sikurse një mësues i papërgatitur, është një antivlerë. Kjo ndodh sepse mësuesi është pasqyrë për nxënësin, është një model që ai e imiton në jetë, edhe dijet dhe kulturën e tij, edhe pamjen dhe zakonet e huqet e tij. Nuk them se ndodh si me ujin që merr formën e shishes, por gjithsesi nxënësi adoleshentë merr shumë nga mësuesi i tij, sikurse dhe nga shokët, por dhe nga prindërit dhe shoqëria në tërësi.



NJË LIBËR ME VLERË TË VEÇANTË PËR HISTORINË SHQIPTARE TË SHEKULLIT XVII



Rreth botimit të "Relatione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Min.ri Oss.ti Rifort.ti Del serafico P're S. Francisco nel Regno d'Albania" të Giacinto Sospello, sjellë në shqip nga Dr. Mark Planikaj, studiuesi i njohur i arkivave.

Etërit françeskanë nga Italia, që kryen misionin e tyre jashtëzakonisht të vështirë në Shqipërinë qendrore-veriore në shekullin XVII, ne u detyrohemi edhe për relacionet e tyre që pasqyrojnë përditshmërinë shqiptare. Raportet përmbajnë përshkrime të territorit dhe të jetës së përditshme të popullive ballkanike, statusit social dhe kulturor të popullsisë. Nga këndvështrimi antropologjik ato janë dokumente shumë interesante, me përshkrime të traditave në jetën private dhe në jetën publike; ato fotofojnë struktura socio-politike me dallime të thella midis zonave; japin fillimet e para të përpjekjeve për shkrim-lexim, sado të kufizuara në sferën fetare, të dhëna për dinamikën e zhvillimeve politike ndërkombëtare dhe

përplasjen e vazhdueshme midis Perandorisë Osmane dhe vendeve evropiane, mbi të gjitha me Republikën e Venedikut, dinamikë që kishte një peshë shumë domethënëse në jetën e misionarëve dhe motivi martirizimit të tmerrshëm të disa prej tyre.

Një vështrim mbi Shqipërinë Qendrore-Veriore në shekullin XVII

Osmanët i pushtuan territoret nën emrin e fesë me synim përhapjen e islamit. Ideali i gazasë, luftës së shenjtë, nuk ishte vetëm një faktor themelor për krijimin dhe zhvillimin e Dvletit Osman, por dhe vetë arsyeja e ekzistencës së tij. Por, xihad nuk do të thotë të shkatërrosh medeomos botën e jobesimtarëve, Dar'l-harb, por para së gjithash ta nënshtrosh atë dhe ta kthesh në Daru'l-islam (mbretërinë e vlerave të islamit). Pra, sulltanët e parë osmanë ishin kryesisht të interesuar për përhapjen e islamit dhe jo për plaçkën e përfitur nga lufta (Maksudoglu, 2017:57-58). A shprehet më qartë se aq dhuna e motivuar nga feja?!

Gjatë pushtimit turk në shekullin XV, shumë shqiptarë u detyruan të emigrojnë dhe katolicizmi u gjend kështu në kushte shumë të trishtueshme; klerikët ishin në një gjendje të braktisur, të paafte për të kryer më detyrat e tyre dhe herë pas here të çrregullt. Pas pushtimit osman katodralet u shkatërruan ose u shndërruan në xhami, siç p.sh. në Lezhë ose Tivar më 1571. I peshkvihtë ose ikën në arrati, ose ranë në robëri osmane, prej së cilës

vështire se mund të shpëtoje. Dioqezat mbetën një kohë të gjatë jetime, ose vetëm sa mbuloheshin prej ipeshkvijve titullarë. Në Lezhë dhe Shkodër ipeshkvijtë u rikthyen vetëm duke u nisur prej vitit 1575, në Sapë prej vitit 1582, në Durrës prej 1640 dhe në Pult në vitin 1668. Të gjithë ipeshkvijtë e kishin selinë nëpër fshatra. Kur prej osmanëve u mor edhe ipeshkvia e fundit shqiptare në Tivar më 1571, izolimi ndaj Perëndimit u bë edhe më i dukshëm (Vrankić, 2016:66-67). Në ato kushte organizimi kishtar pësoi mjaft ndryshime në qendrat ipeshkëvnore, ku disa shuhen, e të tjera bashkohen, si dhe ndryshojnë apo dhe zhvendosen kufijtë ndërmjet tyre. Është një gjendje paqëndrueshmërie që vjen nga procesi i pashmangshëm i shpërbërjes dhe shuarjes nën presionin e islamizimit të popullsisë. Meshtarët e rinj përgatiteshin me pak arsim pranë famullive në gjuhën shqipe. Priftërinjtë u mësonin xhakojve të tyre vetëm sa të lexonin dhe pastaj ipeshkvinjtë, me shkakun se gëzonin privilegjin apostolik, në një kohë të shkurtër u jepnin urdhrat e shenjtë, pa iu bindur normës së Koncilit të Shenjtë të Trentos (Dokumente për historinë e Shqipërisë (1623- 1653), 2015: 453).

Vepërtarinë fetare në vend e mbajtën gjallë misionarët françeskanë. Në vitin 1585 kishin mbetur kuvendet e Sebastes me 10 fretër; të Lezhës 8 fretër; të Rubikut me 7 fretër; të Memlit me 7 fretër dhe të Kepit të Rodonit me 8 fretër, me një numër të përgjithshëm prej 40 fretërish. Dy vjet më vonë kishte 5 kuvende:

Rubik, Lezhë, Sebaste, Kepi i Rodonit dhe Hajmel (Gonzaga, 1587: 931), por në vitin 1589 ishin shtuar edhe katër kuvende të tjera: i Velës, i Oroshit, Qafë Kërrabës dhe Kurbinit (Malaj, 1998: 26)

Rreth relacioneve të Giacinto Sospello-s

Françeskanët kishin në zemër fatin e popullit dhe e kishin përçafuar plotësisht çështjen e tij. Të dëbuar në një anë, ata shkonin në një tjetër, shpesh të veshur si njerëz të thjeshtë dhe kalonin sa në një vend, në një tjetër, gjithmonë mes njerëzve, madje edhe nëpër burgje; ose nëpër male e shpella për të ngushëlluar e mbështetur kushedi sa të arratisur, duke pritur aty të qetësoheshin stuhitë dhe pastaj të ktheheshin për t'u ribashkuar në manastiret e dëmtuara, të cilat i rindërtuan me modesti, për të mos i lënë në mjerim (Sirdani, 2014:172). Gjatë predikimeve të tyre, misionarët u bënë thirrje edhe të konvertuarve në myslimanë që t'i kthehen fesë së "të vërtetë" siç e quanin ata katolicizmin. Ata mund të sillëshin shpirtërisht në dy mënyra: Të mos bënë diskutime teologjike, por t'i afroheshin çdo krijese njerëzore me dashurinë e Zotit, duke e paraqitur veten si të krishterë, ose ta shpallnin fjalën e Zotit në mënyrë publike në përpjekje për të bindur të tjerët (Sammuto, 2011:13).

Misionet françeskane morën përsipër detyrën e vështrimit të ruajtjes dhe të përtëritjes së besimit katolik ndër shqiptarë. Françeskanët vinin

Artisti i munguar, Ikli Punavija, ish-kryetari i këtij grupi folklorik dhe mjeshtër i Laurisë!

Në Gjirokastrë prej disa ditësh ka nisur të buçasë guri e druri nga ritmi, motivi dhe meloditë e instrumentistëve mbarëkombëtarë. Që nga ansamblet e valleve dhe këngëve dhe motiveve popullore e deri edhe tek vetë instrumentistët apo këngëtarët e pavarur. Buçasin dajret, çiftelia, sharkia, lahuta, lauria e Matit, mandolinat, buçet dhe vetë zëri i polifonisë labe tashmë pjesë e trashëgimisë kulturore botërore. Atje në kështjellën historike të Gjirokastrës të mbledhur që nga trevat e Dardanisë, Bjeshkëve me Namë, bregdetit të Ulqinit, Rrafshit të Shkodrës e Lezhës, alpet shqiptare të Tropojës e Nikaj-Mërtur, malësia e Pukë Mirditës, Mat e Dibër, Iliridë, Tiranë, Fier, Elbasanllinj, Gramshiotë, të Librazhdit, Korçarë o të keqen nenja, nga Skrapari, Berati e sazet e Përmetit, po si mund të mungojnë labët? Pa edhe vetë Gjirokastritët që e kanë në derë tyre. Po kanë ardhur dhe Çamët, po edhe Arbëreshët i kanë ruajtur curlt e tyre veç për të ardhur këto ditë që tanë Gjirokastrës i kanë dhënë ritëm e melodi. Sot Gjirokastra është kryeqyteti i ritmit, melodive dhe valleve!

Në skenë munguan mjaft artistë që



fatkeqësisht sëmundja, vdekja dhe paimundësitë të tjera të forta i penguan! Munguan Sherif Dervishi, bilbili Dibran, Laver Bariu Mjeshtër i Madh i sazes Përmetare dhe Imer Neli mjeshtër i fyellit.

Munguan artistët kantautorit i njohur matjan Esat Ruka, këngëtarët e njohur

Drita Suçi, Fatmira Likmetaj, Sabie Rami e të tjerë.

Por për mua mungesa më e madhe e atij festivali mbetet Ikli Punavija. Asnjë pengesë natyrale, asnjë fatkeqësi për të, asnjë pamundësi! Por një dorë njerëzore, një mungesë e vazhdueshme mbështetjeje, një qëndrim indiferent ndaj tij si artist, instrumentist bëri që Ikli ta braktiste jo vetëm Ansamblin e Matit, por të braktiste edhe Shqipërinë në drejtim të Anglisë! Instrumentist i talentuar dhe drejtues i suksesshëm në krye të Grupi Folklorik Petralba Klos që për herë të parë në qytetin e Bashkisë Klos organizoj dy festivale folklorike mbarëkombëtare dhe shumë evenimente të ndryshme artistike brenda dhe jashtë vendit e territorit të Shqipërisë.

Që kur e mësova këtë gjë në mes të dimrit, nuk i vura rëndësi. Thashë do të kthehej, do të vijonte përsëri jehonën me meloditë e laurisë së tij të dashur. Talenti i Iklit është i gjithanshëm, ai është drejtues orkestre, mjeshtër i tingujve të instrumenteve popullore, instrumentist mjeshtër i fyellit, çiftelisë, Laurisë dhe pipëzës. Do të ishte më shumë nder për

këdo që do ta mbështeste Iklën jo për vetë Iklën sepse Ikli e nderon këdo që i shtrin dorën e bashkëpunimit. Pra Ikli është artisti i munguar i asaj skene madhështore me mbi 1000 artistë, me dhjetëra interpretime skenike dhe përpara mijëra spektatorëve që shkojnë e vijnë.

Nëse një ditë do të më jepet mundësia, do të kontribuoj që ikli të jetë jo vetëm i përmendur dhe i mbështetur midis rreshtave të shkrimeve të mia, por artisti që duhet të ketë zë dhe përmes instrumenteve të tij të flasë. Heshtja e kujtdo artisti muzikor, është heshtja që duhet t'i dhembë të gjithë shqiptarëve. Ikli është artist që nuk duhet të mungojë, por duhet të meritojë dhe nga zemra shpresoj që për të mos të jetë vetëm pjesëmarrës i dy edicioneve të shkuara, por edhe edicioneve të ardhshme! Përmes kushtimit për Iklën, mesazhi im është që mesa mundësi të kemi dhe me dorën në zemër të mbështesim çdo artist, këngëtar e instrumentist popullor nga të gjitha hapësirat ku banojnë shqiptarë dhe të gjithë artistët që flasin dhe shkruajnë shqip.

Ermal Lala

nga rajone të ndryshme të Italisë dhe për këtë arsye u përkisnin disa "Provincave", në të cilat ishte strukturuar Urdhri: Piemonte, Veneto, e të tjera dhe në përfundim të misionit të tyre mund të ktheheshin në "Provincën" e tyre të përkatësisë (Nadin, 2022), ndoshta duke marrë me vete kujtime personale, që janë ruajtur në arkiva rajonale, jo vetëm ato romake, dokumente të çmuara për historinë e misioneve dhe në përgjithësi për historinë e Shqipërisë. Një dorëshkrim historik i tillë është zbuluar nga studiuesi i njohur i arkivave Mark Palnikaj, gjatë kërkimeve të tij në Bibliotekën e Bashkisë së qytetit të Feros në Itali, të quajtur Biblioteca Civica "Romolo Spezioli". Dorëshkrimi ka për autor misionarin Giacinto da Sospello, Vikar Apostolik i Shqipërisë dhe mban titullin "Relatione Universale dell'origine, e successo della Missione Apostolica de Frati Min.ri Oss. ti Rifor.ti Del serafico P'rè S. Francisco nel Regno d'Albania". Libri kishte përfunduar në vitin 1652, në Perast, pranë Kotorrit në Mal të Zi, që në atë kohë ishte një qendër e rëndësishme e katolicizmit dhe përfshin periudhën kohore nga viti 1634 deri në vitin 1650 (Jaçaj, 2022). Ai dorëshkrimi mbeti i pabotuar për 370 vjet dhe falë punës me përkushtim të Mark Palnikajt dhe me mbështetjen materiale të vetë atij, u botua vitin e kaluar në origjinal italisht dhe me përkthimin shqip.

Misionarët françeskanë, rrugës për në Shqipëri, qëndruan në Ragusa, e cila pati rol kryesor në përgatitjen dhe mbështetjen financiare të misioneve të tyre. Francesco Bolizza-s sikurse del në korespondencën e tij, përdori lidhjet politike dhe tregtare për të ndërmjetësuar me oficerët osmanë në Shqipërinë që të garantonte sigurinë e françeskanëve. Nga këto letra del qartë se ai ishte në kontakt të ngushtë dhe të rregullt me sanxhak-bejlerët, agallarët dhe jeniçerët e Shkodrës, jo vetëm për shkak të rolit të tij në shërbimin postar, por edhe sepse ishte një figurë ndërmjetëse në tregtinë ndërmjet oficerëve osmanë dhe tregtarëve venedikas (Molnár, 2014:512).

Misionarët hynin në Shqipëri pothuajse në mënyrë ilegale. Ata niseshin nga Ankona, por edhe nga Venecia dhe, në shumicën e rasteve, arrinin në bregun lindor të Adriatikut me anije, duke u ankoruar në Raguzë (Dubrovniku i sotëm), një qytet nën mbrojtjen e Serenissimas dhe prej këtu, përsëri nga deti ose nga toka kalonin në Budva dhe prej andej arinin në Tivar (në Mal të Zi), selia e Arqipeshkëvisë, duke vijuar më pas në vendet e misionit, ku ishin të destinuar në territorin shqiptar, apo edhe në zonat periferike në Maqedoni dhe në Kosovë. Vetë autori i relacionit, Fra Giacinto da Sospello e kishte nisur udhëtimin për Shqipëri nga Roma në vitin 1637 dhe kishte qëndruar me misionin përmes peripecive të shumta deri në vitin 1650. Në vitin 1652, ai përgatiti relacionin (Nadin, 2022), që Mark Palnikaj e ka botuar në një libër.

Sospello e ka ndarë veprën në tri pjesë kryesore. Pjesa e parë prej 53 faqesh pasqyron veshtrimet personale të autorit mbi Shqipërinë dhe banorët e saj. Kapitulli I, trevat veriore të Shqipërisë, krahinat e saj dhe krishterimi; kapitulli II, krishterimi i

maleve të Shqipërisë; kapitulli III, cilësitë dhe traditat e shqiptarëve nga origjina; kapitulli IV, mbi nevojën që ka Shqipëria për misionin apostolik; kapitulli V, rreth origjinës së misioneve apostolike të dërguar në Mbretërinë e Shqipërisë.

Në pjesën e dytë, të titulluar "Relatione delle difficoltà, successi, gesti, frutti, traugli, e persecutioni, occorse nella missione d'Albania dall'anno 1634 sino all'anno 1650", tregohet puna pesëmbëdhjetë vjeçare e misionarëve françeskanë dhe vështirësitë e tyre në Shqipëri. Kjo pjesë përmban të dhëna mbi gjeografinë dhe etnografinë e kësaj province, të perzier fetarisht. Të dhënat e misioneve françeskanë janë të ndara në 16 kapituj të



veçantë. Libri përshkruan historikun e 16 misioneve fetare, të kryera nga autori dhe misionarë të tjerë nga viti 1634 deri në vitin 1650. Aty përshkruhen përpjekjet që bënë misionarët katolikë për edukimin fetar dhe social të popullsisë shqiptare ku ata punuan.

Relacioni i Sospello-s jep të dhëna të hollësishme për gjendjen e katolicizmit në veriun e Shqipërisë në shekullin XVII. Siç del nga relacioni, në atë periudhë kishte dy Arqipeshkëvi: të Durrësit dhe të Tivarit. Arqipeshkëvia e Durrësit ishte e zbrazët për më shumë se 150 vjet, pra që nga pushtimi turk deri sa u emërua Mark Skura për ta qeverisur atë. Edhe Arqipeshkëvia e Antivarit nuk kishte deri atëherë arqipeshkëv; bosh ishte edhe dioceseja e Shkodrës. Ndërsa në vitet 1635-1643, Frang Bardhin, e gjejmë si Ipeshkëv të Zadrimës, si pasues të xhaxhait të tij, të

emëruar Arqipeshkëv i Tivarit.

Në libër jepet gjendja e mjerueshme e klerit vendës. Gjatë pushtimit turk (shekulli XV), shumë shqiptarë u detyruan të emigrojnë dhe katolicizmi u gjend kështu në kushte shumë të trishtueshme; klerikët ishin në një gjendje të braktisur, të paafte për të kryer më detyrat e tyre dhe herë pas here të çrregullt. Duke lexuar relacionin e Padre Giacinto Da Sospello del se ka raste të shpeshta të priftërinjve, që nuk i kishin vizituar kurrë famullitë e tyre "për të mos marrë përsipër vështirësitë e udhëtimit", kështu që fshatra të tëra u braktisën plotësisht. Kishte raste të ndonjë vizite prej disa orësh, në një interval prej një ose dy vitesh dhe, në atë hapësirë kohore, prifti dety-

hospici afër lumit Mat, midis Pdhans dhe Zadrimës. Në vitin 1640, Fr. Cherubino, pasi u bë Prefekt i Misionit, e zgjeroi gamën e misioneve dhe mori ndihmë të re nga Roma, themeloi tri hospice të tjera në: Shas, Derven dhe Grudë; hospici i Dervenit, që vepronte në vendbanimet e fushës deri në Durrës, dhe nga ana tjetër deri në Mullet. Në male ai përfshinte të gjithë Bendën deri në Tomadhea dhe më tej deri në kufijtë e Dibrës së Sipërme, në Luginën e Sopotit, duke kaluar Vajkalin e Skënderbeut; hospici i shtatë u themelua mbi liqenin e Shasit, në një vend të shkretë, ku ishte kisha e Shën Pellegrinit, në distancë pothuajse të barabartë nga tre qytetet: Shkodër, Ulqin dhe Tivar.

Libri i Sospellos është një lloj historie jo vetëm e ngjarjeve dhe e rrjedhave që e cilësuan periudhën e përmendur në rrafshin fetar e shpirtëror, po dhe në atë shoqëror, politik, ekonomik, kulturor dhe arsimor në një hapësirë të madhe të Arbërisë. Libri pasqyron qartë pozitën inferiore të katolikëve krahasuar me myslimanët, para të cilëve duhet të ishin të nënshtruar dhe të bindur. Misionarët para se të vendoseshin në një vend merrnin takim me autoritetet e vendit dhe me klerikët vendës, pra ishin në rregull me ligjet dhe traditën e vendit, megjithatë ata u nënshtroheshin rrethave rastësore, mund të arrestoheshin nga çdo zotëri turk, të goditeshin, madje dhe të vriteshin, prandaj gjatë misionit të tyre ata i merrnin parasysh të gjitha (Sospello, 2023:67). Misionarët dhe klerikët e tjerë ishin të pambrojtur dhe u nënshtroheshin pa shkak torturave të turqëve, siç ishte rasti me famullitarin e Pdhans, At Andrea Karlanji (Sospello, 2023: 225-226). At Giacinto goditet me shkop nga një turk, vetëm për faktin se nuk ngrihet në këmbë kur kalon ai (Sospello, 2023:325). Në vitin 1636, misionarët kërcënohen në Mazrrek (Sospello, 2023:67). Në Gjakovë misionarët kishin paguar për lirim të tyre. Në vitin 1637, ushtarët turq kishin hyrë në uratoren e Trushit, duke i detyruar misionarët që të largoheshin (Sospello, 2023:116).

Një i krishterë ishte kapur në qytetin e Pejës nga turqit, sepse kishte një borxh, dhe e kishin kërcënuar se nëse nuk do ta paguante t'u çonte vajzën, ndryshe do ta varnin. Dhe ai pranoi më mirë vdekjen për vete se dhunimin e të bijës (Sospello, 2023:265-266).

Të krishterët e konvertuar në myslimanë nganjëherë mbajnë qëndrim dashamirës, madje dhe praktikojnë disa rite të krishtera. Gratë e myslimanëve shkonin te misionari që të dëgjonin besimin e shenjtë dhe kishin devocion për virgjëren tejet të shenjtë që ato e quanin Mejreme (Sospello, 2023: 160). N

Kishte raste që myslimanët riktheheshin në krishterim në prag të vdekjes (Sospello, 2022: 111).

Popullsia shqiptare kishte bestytini, ndaj të cilave misionarët u desh të ndërhynin shumë, në mënyrë që t'i çlirojnë prej tyre (Nadin, 2021: 14). At Giacinto me Fra Bonaventuren shpëtuan në Perast gra që i kishin lidhur dhe po i hidhnin në det, të përgojuara si shtriga. Priftërinjë gati kudo pagëzonin edhe fëmijët e myslimanëve, jo që të bëheshin të krishterë, por që të kishin shëndetin e trupit, të mos kishin erë të keqe, e të mos shqy-

heshin nga ujçërit. Misionarët ishin pranuar përgjithësisht nga popullsia, por edhe nga autoritetet për shkak të anagzhimit të tyre si mjekë. Edhe myslimanët i merrnin misionarët për shërbime shendetësore dhe besonin në aftësitë shëruese të tyre. At Kerubini shëroi një të çmendur, të birin e Alisak Begut. At Giacinto kishte shëruar djalin e Hysen pashës së Pdhane, i cili studioje për hoxhë (Sospello, 2023: 230-231). Në Hospicin e Troshanit ndodhej edhe infermieri, Fra Felice. Edhe Fra Humile ishte infermier, që kishte shëruar shumë të sëmurë (Sospello, 2023: 106-109). Në Pdhane, një zotëri mysliman u kishte kërkuar misionarëve që të ngrinin

2023: 285-286). Ka shumë raste të tilla që jepen në libër.

Edhe një herë për konvertimin e katolikëve në myslimanë

Administrata osmane provoi mënyra të ndryshme për të ruajtur sundimin e tyre mbi shqiptarët, veçanërisht duke u imponuar fenë myslimane shqiptarëve me anë të masave diskriminuese fetare. Sipas historianëve shqiptarë, islami u përhap më gjerësisht në Shqipëri se në viset e tjera të Ballkanit për shkak se mjetet e shtrëngimi i përdorur atje ishin më të mëdha. Me anë të betejave të organizuara për të nënshtruar të krishterët ortodoksë të Sulit, Himarës dhe krahinave të tjera


ruan mu përpara mureve të Shkodrës. Pas rezistencës shqiptare, shumica dërmuese e objekteve të kultit u shkatërruan dhe pjesa më e madhe e klerikëve u larguan jashtë vendit apo u strehuan nëpër male. Në atë periudhë ishte vështirë të ishte katolik, për shkak të sakrificave që duheshin bërë, qoftë me pranimin e një statusi më të ulët shoqëror, ashtu dhe të diskriminimit të qartë ekonomik që shprehet me ndërkesën me më shumë taksa krahasuar me myslimanët. Në përgjithësi, presioni ekonomik që ushtrohej mbi të krishterët nëpërmjet taksës së xhizjes që ishte detyrimi që paguhej pasi nuk i nënshtroheshin shërbimit ushtarak. Me përkeqësimin progresiv të buxhetit të shtetit osman,

Zadrimë ktheheshin në myslimanë, merrnin ndonjë myslimane për grua ose u japin myslimanëve vajzat për martesë (Sospello, 2022:153)

Ajo pjesë e klerikëve që vazhduan të shërbenin në vend e paguan devocionin e tyre me humbjen e jetës, çka nuk kishte si të mos ndikonte te besimtarët. Vrasjet e klerikëve ishin dukuri me të cilët njerëzit nuk ishin mësuar, prandaj shoqëroheshin me frikë dhe pasiguri. Katolikët shqiptarë në atë periudhë nuk kishte kush t'i mbronte dhe ata nuk kishin ku të ankoheshin për çfarëdo lloj dhune të ushtruar ndaj tyre. Arsyeimi historik për konvertimin u gjet në "natyrën agresive" të fesë islame, e shprehur në konceptin e luftës së shenjtë (xhihad). Me fjalë të tjera, konvertimet u konsideruan të kishin ndodhur nën detyrim - qoftë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Kështu, duke e paraqitur popullsinë vendase të islamizuar si viktime të persekutimit (Minkov, 2004:64). Anastasia Zelyazkova e shmang me kujdes përdorimin e termit konvertim "vullnetar" në Islam duke adoptuar termat "shtrëngim i drejtpërdrejtë" dhe "indirekt" ose "ekonomik". Detyrimi "i drejtpërdrejtë", si konvertimi përmes institucioneve të skllavërisë dhe devshirme, shihet se ndodh "nën kontrollin dhe me pjesëmarrjen e qeverisë qendrore". Në këtë formë konvertimi "mundësia e zgjedhjes personale, aq më pak, e vullnetarizmit, është plotësisht e përjashtuar" (Minkov, 2004:65). Edhe pse llojet e tjera të konvertimit nuk nxiten nga qeveria dhe duken në sipërfaqe si vullnetare, ato ende konsiderohen shtërngim "indirekt" për shkak të "integritit të detyruar" të popullit të pushtuar në struktura e mekanizmit perandorak.

Vetë historianët turq e përziejnë dhunën osmane me fenë. Në librin "Historia Osmane dhe institucionet I", ku çdo pushtim të ri, të kryer me luftë, e konsiderojnë si "hapje ndaj islamit" (Maksudoglu, 2017:170-196). Trajtime të tilla shoqërohen me kontradikta në arsyetim. Kështu, ndërsa flet për përhapjen paqësore të islamit, Mahmudoglu shkruan se "Fatih Mehmeti dërgoi Isa Beun, të birin e Evrenozit në krye të 40 mijë kalorësve, për t'u hakmarrë ndaj disfatës së shkakuar nga shqiptarët, si dhe për të vijuar misionin e përhapjes së islamit në këtë rajon (Maksudoglu, 2017:168-169). Për t'u hakmarrë me ushtri, pra duke përdorur dhunën, njëkohësisht duke përhapur dhe fenë. Po si u përhapka feja në mënyrë paqësore nga ushtria që përdor dhunën?(!)

Të konvertuarit e parë duket se kanë qenë robërit e luftës. Sipas Zelyazkovës (1990:150-151), konvertimi i popullsisë ballkanike nëpërmjet skllavërisë ishte karakteristikë e fazave fillestare të ekspansionit osman në Ballkan, një proces që zakonisht paraprihet nga përfshirja aktuale e një rajoni të caktuar në shtetin osman. Për të vërtetuar se përfundimisht shumica e skllavëve u konvertuan në islam, ajo tregon për praktika mes myslimanëve të devotshëm të lirit të skllavëve, pas konvertimit të tyre dhe për tregtinë e gjerë osmane të skllavëve në kohët e mëvonshme (Minkov, 2004:66). Meqenëse pushtimi i territoreve shqiptare është bërë pas luftërave të ashpra, pushtuesit osmanë kanë përdorur forma



një Hospic atje dhe të merrnin një infermier laik që të kujdesej për të sëmurët që vdisnin pa asnjë ilaç dhe kujdes (Sospello, 2023:128). At Kerubini ishte thirrur që të shkonte me një frat infermier në një fshat pranë Shkodrës, për të shëruar një mysliman që ishte çmendur, i cili ishte vëllai i njërit prej drejtuesve kryesorë. (Sospello, 2023: 156). Fra Kozimo, që ishte misionar në Shën Pelegrin, afër lumit Buna, ishte infermier i virtutshëm dhe i gjindshëm, si dhe shumë praktik në lëndën e kirurgjisë dhe në përgatitjen e ilaçeve dhe medikamenteve. Tek ai shkonin dhe zotërinj turq të Tivarit, Ulqinit dhe të Shkodrës (Sospello, 2023:288).

Por myslimanët, ashtu si dhe të krishterët besonin se Ungjilli kishte aftësi shëruese, vepronte kundër sëmundjeve, mbi fushat, vreshtat dhe kundër çdo pranie djallëzore dhe sëmundje (Sospello, 2023: 159). Ishte gjë e zakonshme në të gjitha anët e Shqipërisë, që fetërit të thërriteshin nga të sëmurët që t'u lexohej Ungjilli dhe t'u shkruheshin letra, pavarësisht nëse ishin të krishterë apo turq. Një mysliman në Derven që i kishte dhënë tokën Misionit u sëmurë dhe At Antoni nga Spoleto që banonte aty i lexoi Ungjillin dhe ai ndjeu një përmirësim (Sospello,

që përfitonin nga njëfarë pavarësie, ai i detyroi shqiptarët të zgjedhin islamin për t'i shpëtuar mizorisë osmane (Daniel, 1990: 6-7). Nuk ka dyshim se gjatë kalimit nga oikumene latino bizantine në umetin multietnik mysliman, shumë njerëz u përballën me dhunën politike, paragjykimet fetare dhe brutalitetin ushtarak, që luajtën një rol të rëndësishëm Kopański, 1997: 193). Përderisa greku më parë jepte lirinë se besimin, te shqiptarët mesatarisht ishte e kundërta. Shqiptari është i gatshëm të paguajë lirinë nga shtypja politike me çmimin e besimit të trashëguar. Kjo bindje ka gjetur shprehjen e saj në proverbin e njohur shqiptar "ku është shpata, është feja" (Hahn, 1854: 35).

Për të gjykuar mbi konvertimin e katolikëve duhet marrë në konsideratë gjendja e Shqipërisë Qendrore-Veriore në shekullin XVII. Armiqësia midis Shqipërisë katolike dhe Perandorië osmane çoi në shkatërrim të gjërë të zonave të rezistencës nga osmanët, midis viteve 1466-1479. Në Dibër e Mat midis dy të tretave dhe tre të katërtave të popullsisë u vranë ose u morën skllavër. Mbrojtësit e Dristit, qendrës kulturore të kulturës katolike të Shqipërisë Veriore, të famëshme për shkollën e saj latine dhe priftërinjtë shumë të arsimuar u masak-

gjendja ekonomike e të krishterëve u bë gjithnjë e më e rëndë dhe për pasojë ka qenë gjithmonë e më e fortë shtypja për të hequr dorë nga krishterimi dhe për të përqaftuar islamin (Sciara, 1996:4). Taksat dhe detyrimet e rënda të një pushteti tiranik turk, angaritë e përbindëshme dhe shtërngesat e ulta nga zotërinjë feudal bëjnë që të krishterët "të humbasin jetën e përjetshme për jetën në këtë tokë". Në këto rrethana dhe kushte ka përfunduar Benda, pjesa më e madhe e Musisë, Bandisa, matia, pjesa e Çermenikës dhe vende të tjera (Sospello, 2022:29). Nga Fusha e Durrësit disa të krishterë ishin larguar nga vendet e tyre dhe kishin shkuar në Turqinë e brendëshme, ku ishin bërë kolonë të zotërinjëve turq, punojnë tokën, duke jetuar në mjerim të madh bashkë me familjet e tyre (Sospello, 2022:8). Për të paguar taksat, banorët e Nënshkodrës ishin të detyruar të shisnin pjesën më të madhe të pasurive të tundëshme dhe të patundëshme e për këtë arsye kishin përfunduar në mjerim të madh e kështu, me vështirësi mund ta dallosh të pasurin nga i varfëri, fisnikun nga jofisniku, duke qenë se të gjithë kishin kaluar në mjerim dhe ishin të veshur me lecka (Sospello, 2022:4). Për të shpëtuar nga taksat, në

brutale të shtypjes së rezistencës, ku krahas vrasjeve të meshkujve të aftë për luftë, është përdorur skllavërimi i pjesës tjetër të popullsisë. Skllavëria realizohej dhe përmes sistemit të haremit dhe devshirmesë.

Vajza të bukura, të marra peng mbulleshin në haremet burgje, ku dhe konvertoheshin në myslimane dhe pastaj shërbenin si objekte seksuale për sulltanët, vezirët dhe pashallarët osmanë. Në rastin e konvertimeve në islam nëpërmjet institucionit të devshirmesë, ithtarët e "teorisë së detyrimit" duket të jenë të saktë kur pohojnë se "konvertimi i detyruar në një shkallë të madhe ka ndodhur me të vërtetë". Termi devshirme i referohet taksës qeveritare të fëmijëve meshkuj nga popullata jomuslimane, e vendosur periodikisht nga fillimi i shekullit të pesëmbëdhjetë e në vazhdim, e krijuar për të mbushur radhët e korpusit të jeniçerëve. Zhvillimi ishte një risi osmane; e rregulluar vetëm me ligjin sulltanor (kanun) dhe duket se është një shpërfillje flagrante e parimeve të ligjit islam që prekin statusin e dhimit. Sipas çdo standardi, largimi i një djali nga familja e tij duhet të ketë qenë një ngjarje traumatike për të dyja palët Minkov, 2004:65, 70), si për djalin dhe familjen e tij.

Martirizimi i klerit katolik

Në studime të ndryshme martirizimi është përshkruar si tregues i "shpërthimit të fanatizmit mysliman gjatë realizimit të islamizimit masiv". Theksohet se martirëve u bënë presion dhe i torturuan për t'u konvertuar në islam dhe në fund i vranë, sepse refuzuan ta bënin këtë (Minkov, 2004:84). Megjithëse veprimtaria misionare në Shqipërinë e shekullit XVII ishte një nga më të rrezikshmit në Gadishullin Ballkanik nën sundimin Osman (Molnár,2014:512-513), ashtu si në shekujt e parë të krishterimit, përndjekjet nga turqit në Shqipëri nuk ishin gjithmonë intensive (Sirdani, 2014:172). Persekutimi i katolikëve u intensifikua pas luftës turko-veneciane të vitit 1645, kur ata u konsideruan si armiq për shkak të marrëdhënieve të tyre me Papatën, Napolin dhe Venedikun. Në atë periudhë, kishte një presion në rritje nga turqit për të konvertuar të gjithë shqiptarët në islam (Lederer, 1994:333).

Të krishterët mund të jetonin në Shqipërinë e sunduar nga osmanët vetëm si qytetarë të dorës së dytë; mund të përndiqeshin, burgoseshin dhe rriheshin. Më keq ishte pozicioni i klerikëve katolikë dhe sidomos i misionarëve, të cilët mund të akuzoheshin lehtësisht si "bashkëpuntorë të shteteve armike", "spiunë" e të tjera, të burgoseshin dhe të vriteshin me lehtësi. Falë gatishmërisë së tyre për flajm apostolik dhe qëndrueshmërisë, ata kishin marrë përsipër punën baritore-shpirtërore gjithëkund në shekujt vijues në territoret katolike ku kishin kryer punët baritore-shpirtërore. Mirëpo ky veprim u kishte kushtuar me vdekje martire shumë françeskanëve misionarë guximtarë. Kështu në vitin 1624 prifti i zellshëm Markus nga Kizanzi, një fshat i cili sot nuk ekziston më, burgoset dhe pasi që ai refuzon kalimin e tij në islam vritet. Kufoma e tij, mbas një pagese që kishin dhënë besimtarët e tij për nxjerrjen e saj, varroset në famullinë e vendlindjes (Stadmüller, 1955: 404-429).

Dhuna ekstreme përdorej me raste, për të terrorizuar të gjallët, ndërsa rrahjet, burgosjet, djegiet e kishave dhe hospiceve, kërcënimet, grabitjet e klerikëve e të tjerë. Ishin veprime të përditëshme. Në vitin 1639, P. Bernardo da Verona qe arrestuar dhe dërguar para Pashait të Gjakovës, ku pas presioneve për të ndryshuar fenë, meqë nuk kishte pranuar e kishin rrahur dhe ishte liruar kur të krishterët kishin dorëzuar 30 reale. Në Randësia disa burra nuk pranuan të bëheshin turq, por duruan tortura të tmerrshme (Sospello, 2022:143) Fra Bernardo Veronese dhe fra Gregori nga Novara ishin dërguar para kajmekamit dhe Kadiut, të cilët i kërcënuan se do t'i dënonin me vdekje dhe nga frika të krishterët paguan 30 reale e i liruan (Sospello, 2022: 147).

Mungesa e sigurisë në vend u linte dorë të lire elementeve kriminelë që për llogari të tyre të vinin dorë mbi klerikët. Kur vrasja ndodhte nga katolikë është dëshmi e degradimit të jetës shpirtërore të besimtarëve, pasi klerikët ishin aq të mbrojtur, sa asnjë besimtar nuk do të guxonte as ta kalonte nëpër mend vrasjen e tyre. Në vitin 1644, etërit françeskanë Paulo da Montova dhe Salvatore da Ofida u nisën nga Gruda për në Kelmend për të kryer atje shërbimin shpirtëror për popullsinë. Megjithëse ishin paralajmëruar nga banorët vendës që të mos shkonin se mund të vriteshin, ata kishin vijuar udhëtimin nën shoqërinë e një gruaje të quajtur Margarita Deda, meqenëse burrat e Grudës kishin rënë në gjak. Dy fretërit kishin qëndruar te kreu i fshatit Prenk Nika, i cili mbante konkubina. Gjatë meshës dhe pas saj, të dy fretërit misionarë kishin kërkuar që të gjitha ata të cilët mbanin konkubina të liroheshin prej tyre dhe të respektonin martesën e ligjshme. Rrugës në kthim ata ishin vrarë për t'i grabitur ose pse u bënë shkaktarë që të dëbohej nga shtëpia e burrit ku ata kishin predikuar gruaja e pa kurorë. Në procesin hetimor që u zhvillua pas vrasjes, ishte dhe frati misionar Xhakomo da Sarnano, i cili vite më vonë do të martirizohej në tregun e Shkodrës (Malaj,2020:194).

Në vitin 1645, pas shpërthimit të luftës venediko-turke në Kretë (1645-1669), ipeshkvijtë katolikë të Durrësit, Shkodrës dhe Lezhës të nxitur nga Arqipeshkvi i Tivarit, ishin angazhuar në favor të venedikasëve. Plani zbulohet dhe dështon. Kjo ka qenë një arsye e re e përndjekjes e popullsisë katolike. Me këtë rast, arqipeshkvijtë e Shkodrës dhe Sapës ishin detyruar të iknin në territorin venedikas, për t'u shmangur vdekjes. Por dy françeskanë, Ferdinandi nga Abbisola dhe Jakobi nga Sarnano, që trimërisht qëndruan në Shkodër, i ngulën në hu të gardhit me urdhërin e pashait (Stadmüller, 1955: 404-429). Po kështu ishin vrarë edhe të tjerë. Nga viti 1620 deri në vitin 1750 janë vrarë 11 fretër vetëm në dioqezat e Pultit dhe Shkodrës. Shqipëria në shekullin e 17-të, shkollat shqipe dhe kleri katolik përballë sundesve osmanë (Jaçaj, 2022). Mënyra e vrasjes së tyre, e bërë publikisht nga turma të irrituara apo të ekzaltuara, nga grupe të armatosura, apo dhe ushtarë që i sulmojnë shpesh gjatë takimit rastësor me ta nuk mund ta fshehin faktin se ishin të orekstruara nga zyrtarë shtetërorë, pasi vrasësve nuk u hyn ferrë në këmbë për

krimet e kryera.

Marrëdhëniet ndërfitare

Me pushtimin osman dhe përhapjen e islamit, pasoi një formë unike e sinkretizmit fetar me krishterimit, islamit dhe paganizmit, i cili manifestohej më së miri në fenomenin e kriptomartirëve dhe dëshirës për t'u ndarë sakramentet edhe të afrëmvë myslimanë, si shenjë dashamirësie dhe lidhje farefisnore (Vrankić, 2016:8). Katolikët nuk i kanë përfillur ndërhyrjet e klerikëve dhe martesat e përziera kanë qenë një dukuri e zakonshme në disa krahina. Populli kishte gjetur zgjidhje me tolerancë fetare në çështjet e koklavitura të këtyre familjeve. Në mes të tjerash, po përmendim rregullin e përgjithshëm që djemtë të mbanin besimin e t'et, kurse vajzat të nënës. Në relacionet e Giacinto da Sospello-s del se "turqizimi" ishte një dukuri e zakonshme dhe të turqizuarit e katolikët e mbetur jetonin së bashku në një familje" (Stadmüller,1955:404-429), në një përzjerje besimi, pasi i kishin të përbashkëta interesat, traditat shoqërore, ndjenjat dhe shërbesat fetare. Muslimanët për shembull vazhdonin t'i ruanin traditat e krishtera. Nuk punonin të dielën, merrnin dhe jepnin vajza për martesë ndër katolikët, shkolin te Frati për të lexuar Ungjillin, kur kishin ndonjë familjaër të sëmurë. Kishte raste që fëmijëve u kishin vendosur dy emra, një mysliman dhe një të krishterë (Kordinjano, 2011: 131).

Edhe kur islamizimi u përhap në vise të ndryshme të trevës malore, feja e re nuk mundi ta prishë vëllazërinë midis malësorëve. Në kushtet e luftës kundër sundimit osman e të diskriminimit të egër fetar, kërkohej një bashkëpunim i fortë ndërmjet malësorëve. Kësaj çështje i shërbente vazhdimi i lidhjeve martesore pa marrë parasysh besimin, si një faktor i rëndësishëm bashkimi. Ishin të shumta doket e malësorëve (kumbaria, vëllamëria, e të tjera), që binin në kundërshtim të hapur me urdhrat e fesë. Kumbaria e martesës është më e vonë se ajo e flokëve, por me gjithë këtë, malësorët edhe këtu nuk bënë dallim fetar. Ata zgjidhnin për kumbarë edhe ortodoksë e myslimanë (Ulqini, 2014).

Rastet e bashkëjetesës të evokuara këtu dominohen nga familje të përziera të formuara kryesisht nga gra katolike dhe burra myslimanë (burimet përmendin raste të rralla kur burrat katolikë martoheshin me gra myslimane, por zakonisht martesat të tilla çuan në konvertimin e këtyre të fundit në katolicizëm. Lidhja farefisnore e krijuar në këtë mënyrë midis familjeve myslimane dhe të krishtera. nënkuptonte detyrime të tilla si p.sh. pjesëmarrja në funeralet myslimane ose në festat dhe banketet e organizuara nga të afërmit myslimanë për përkujtimin e të dashurve të tyre që kishin ndërruar jetë. Festat e zakonshme nuk organizoheshin vetëm nga myslimanët; në fakt, disa burime i referohen traditës së keqe të shumë katolikëve për të organizuar festa për tre ditë për çdo të huaj (përfshirë myslimanët); një shoqërim ritual që nuk merrte parasysh dallimet fetare. Duke iu rikthyer çështjes së martesave të përziera, mund të vërehet se shumica e burimeve i referohen atyre si në kundërshtim me kanunet kishtarë, sidomos ato të miratuara nga Këshilli i

Trentit (Chelaru,2011:307). Natyrisht, mund të jetë gjithashtu rasti që burrat myslimanë ishin të krishterë renegatë, të cilët dëshironin të mbanin të paktën gratë e tyre nën mbrojtjen e kishës romake (Chelaru,2011:30) . Kjo gjë i detyroi disa klerikë shqiptar si Gjergj Bardhi më 1632 e Frang Bardhi më 1637 të kërkonin nga Roma që të njihej realiteti i Malësive shqiptare.

Kisha katolike është orvatur që këto martesat të përziera t'i pengojë. Nëpërmjet një dekreti të posaçëm, më 1641 Kuria (Selia Shenjte, vër. e përkthyesit) ua ndaloi pagëzimin fëmijëve që kishin prindër myslimanë dhe më 1678 sinodi ipeshkvnor i Shkodrës ua ndalon shprehimisht, grave që jetojnë me "turqit" të marrin sakramentet (Bartl, 2006). Myslimanët nuk duhet që të shërbenin si kumbarë në pagëzimin e fëmijëve. Martesat e grave të krishtera me burra turq duheshin konsideruar si thyerje kurore, urdhëroreshin që të ndaheshin, përndryshe do t'u ndaloheshin sakramentet (Sospello, 2023; 152). Klerikët në Gjakovë i kishin këshilluar vajzat e krishtera që më mirë të rrinin të pamartuara, sesa të merrnin myslimanë (Sospello, 2023;77).

Në kuvendin e parë të Arbnit më 1703 u vendos që të mos njihej e të mos kryhej asnjë martesë e katolikëve me myslimanë e me ortodoksë. Ndërsa kleri mysliman e pranonte martesën e një burri me një grua të krishterë, për ta kthyer në fenë islame; sheriati ndalonte martesën e një myslimaneje me një të krishterë. Përgjithësisht malësorët nuk i kanë përfillur ndërhyrjet e klerikëve dhe martesat e përziera kanë qenë një dukuri e zakonshme në disa krahina. Misionarët e huaj që shërbenin në vendin tonë i kanë akuzuar klerikët e thjeshtë vendas se ishin pajtuar me atë gjendje ku popullsia u binte ndesh urdhëresave të Romës. Ky qëndrim i klerit të ulët e kishte burimin në radhë të parë në faktin se ata kishin lindur e ishin rritur në atë mjedis, të shumtën e herës pa arsim fetar e pa nivel teologjik në krahasim me klerikët e huaj. Por klerikët e thjeshtë katolikë shqiptarë i kuptonin më mirë se kushdo tjetër rrethanat që kalonte shoqëria shqiptare e kohës (Ulqini, 2014). Shoqëria shqiptare kishte trashëguar diversitetet fetar që me ndarjen e kishës së krishterë në ortodokse dhe katolike dhe sipas të drejtës tradicionale shqiptare iu përgjigj kushteve të vendit tonë me popullsi fetarisht të përzjer, praktikë që u vazhdua dhe gjatë pushtimit osman.

Libri "Relacion universal i zanafillës dhe I suksesit të Fretërve Minorë Observant të Reformuar të Atit serafik Shën Françeskut në Mbretërinë e Shqipërisë" që e sjell në shqip për herë të parë studiuesi Mark Palnikaj është një kontribut me shumë vlerë në historinë e Shqipërisë Qendrore-Venore të shekullit XVII, duke dhënë pamjen më të plotë e më gjithëpërfshirëse të asaj shoqërie, e cila jetonte midis pushtimit dhe përpjekjeve për çlirim, midis asimilimit fetar dhe qëndrueshmërisë në fe, midis vuajtjeve dhe zhgënjimeve dhe forcës që vinte nga misionarët, të cilët ua përcollën të gjallë shembëllturën e Krishtit në kryq besimtarëve.

Shqiptarë, kudo që jeni, flisni shqip me fëmijët tuaj



Fran Gjoka

Emigracioni, gjatë gjithë periudhave të historisë, ka qenë dhe është një fenomen tipik social me karakter ndërkombëtar. Edhe Shqipëria,

në këtë aspekt, nuk ka bërë dhe as nuk bën përjashtim. Periudha e vështirë e tranzicionit u shoqërua me një hemoragji të pandalshme të procesit të emigrimit të popullsisë së vendit tonë, sidomos në drejtim të vendeve perëndimore, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës, sigurisë për të ardhmen dhe kualifikimit arsimor të fëmijëve. Pra, emigrimi i popullsisë në përgjithësi dhe i fëmijëve në veçanti, krahas anës pozitive, mbart në vetvete edhe rrezikun e një asimilimi gradual të gjuhës sonë shqipe, sidomos tek fëmijët dhe tek rinia shqiptare, që jeton aktualisht në mërgim. Fati i ekzistencës së një kombi përcaktohet, në fund të fundit, nga ruajtja e gjuhës dhe kulturës së tij. Populli i një vendi, që për arsye të ndryshme nuk e shkruan dhe nuk e flet gjuhën e tij amtare, është i destinuar të asimilohet pasi gjuha dhe kultura janë tiparet krtesore që e dallojnë një komb nga një tjetër. Kur njeriu nuk e ka nën këmbë tokën e vet, humbet diçka nga qëndrimi i tij vertikal, humbet sigurinë dhe në shumë raste bëhet më mosbesues ndaj vetvetes. Është interesant fakti se gjuha shqipe ka një zhdërvjelltësi në të folur, është shumë burrërore dhe mjaft e bukur. Këtë e kanë vënë re edhe mjaft albanologë dhe gjuhëtarë të huaj, të cilët thonë se gjuha shqipe jo vetëm ka një tingëllim të veçantë shprehës, por dhe harmoni të gjerë, gjë që i jep një mundësi të madhe shprehëse të dretpërdrejtë dhe thellësisht metaforike. Kjo ndodh jo vetëm se shqipja është vazhdim i ilirishtes, që bën pjesë në grupin e gjuhëve të hershme Indo-Europiane, por dhe se kohët e fundit ajo është pastruar në mënyrë të dukshme nga fjalët e huaja. Është detyrë e rëndësishme e mësuesve dhe prindërve mërgimtarë që t'u mësojnë fëmijëve shqiptarë, kudo që jetojnë, gjuhën e bukur shqipe. Shqiptarë të vërtetë, patriotë dhe atdhetarë dhe mësues të apasionuar ka plot, si ata që dërguan libra, hapën shkolla, hartuan programe. Këtu më vjen në mend një thënie e një mërgimtarit me banim në Itali, i cili, kur ra fjala për gjuhën e nënës, më pati thënë: "...Gjuha është elementi kryesor që trgon se ne jemi shqiptarë, kudo që ndodhemi...". Parë nga ky këndvështrim, përfitoj nga rasti t'u bëj thirrje mësuesve atdhetarë, prindërve mërgimtarë, që t'u mësojnë fëmijëve si ta flasin dhe të shkruajnë pandërprerje shqipen, gjuhën që të parët tanë na e lanë për ta përdorur përgjithmonë të pastër. Përmes

mësimin të mirë të shqipes së folur dhe të shkruar, fëmijet në diasporë do të mbajnë më lehtë lidhjet me vendlindjen dhe në të gjitha viset shqiptare.

Historikisht mërgimtarët shqiptarë kanë punuar, kanë jetuar dhe janë përpjekur që fëmijëve të tyre t'ua mësojnë dhe ta ruajnë gjuhën shqipe. Kjo traditë e çmuar, si amanet i rëndë i të parëve tanë, "që së tret dhe i huaj", deri në ditët tona, duhet të ruhet. Hemoragjia e pasviteve '90 të shekullit të kaluar, që ka bërë tashmë të shpërngulen nga atdheu, për një jetë më të mirë, me gjithë familjen, ka detyruar mërgimtarët shqiptarë, këtej dhe matanë kufijve tanë që t'u përshtaten kërkesave të reja të epokës së globalizimit, ku është bërë i dukshëm rreziku i humbjes së kulturave nacionale pra, edhe të gjuhës nga breznitë e reja. Është për t'u theksuar se tashmë për fëmijët e mërgimtarëve janë hapur shkolla të shumta në vende të ndryshme, ku fëmijët marrin në mënyrë të organizuar mësim plotësues në gjuhën amtare nga mësues patriotë e pasionantë, të cilët, në të shumtën e rasteve, e japin ndihmën e tyre vullnetarisht. Shembujt janë të shumtë dhe gjendja e këtyre shkollave, mund të themi, se përfshijnë hapësira të reja, ku jetojnë e punojnë shqiptarët. Për çeljen dhe mbarëvajtjen e këtyre shkollave kanë dhënë ndihmën e tyre dhe drejtuesit e pushtetarët lokalë si në qytetet Nju Jork, Bruksel, Hamburg, Berlin, Frankfurt,

sidomos nga ata të Kosovës dhe të trojeve të tjera ku jetojnë shqiptarë. Synimi i këtyre vendeve dhe shkollave mbetet i qartë: fëmijët e mërgimtarëve të zotërojnë mirë shkrim–lexim në gjuhën amtare shqipe, ta kultivojnë atë dhe letërsinë shqipe, të njohin historinë dhe gjeografinë etnike të vendit të të parëve si dhe artin, kulturën dhe traditat kombëtare. Rëndësi të veçantë, në këto shkolla shqipe, u kushtohet veprimtarive të lira jashtë klase, si: puna me librin, funksionimi i bibliotekave, konkurse dhe biseda për librin etj. Kjo është gjë e mirë, sepse po bëhet edhe ndërgjegjësimi i vetë diasporës për rolin vendimtar që ka shqipja e folur dhe e shkruar për fëmijët, detyrimisht e ruajmë edhe identitetin tonë kombëtar. Vërtetë jetojmë në një shoqëri të lirë e të hapur, vërtetë jemi përkrahës të globalizimit dhe të rejave që po hyjnë në shkencë dhe teknikë, por nuk do të dëshironim kurrë që gjuha jonë e bukur të mos shkruhet e të përdoret nga shqiptarët e të gjithë brezave që do të vijnë. Mundësitë për ta mbajtur të gjallë gjuhën e bukur shqipe, gjuhën e Naimit tek nipërit, mbesat dhe stërnipërit tanë, pavarësisht se ku lindin e ku jetojnë ata, janë të dukshme. Ata, pavarësisht nga mjedisi i huaj ku jetojnë e punojnë, nga rrethanat aspak favorizuese për të përdorur gjuhën shqipe, askush nuk i pengon të flasin vetëm shqip në familje, të komunikojnë me fëmijët e tyre vetëm përmes

nuk ua kanë mësuar gjuhën shqipe, apo kemi raste të tjera që njëri nga prindërit është martuar me të huaj, pësëri gjuhën e nënës duhet ta flasin fëmijët. Ky veprim i prindërve shqiptarë është krejtësisht e patolerueshme. Për shqiptarët mërgimtarë, megjithë përpjekjet e mundimshme për ruajtjen e gjuhës, shqipja po bëhet e largët dhe e huaj për fëmijët e tyre. Është normale që duke jetuar në një shoqëri ku flitet një gjuhë tjetër, kuptohet dhe tendenca e kufizimit dhe shqiptimit të shqipes vjen dhe zbehet, por fëmijët duhet të projektojnë të ardhmen e tyre aty ku rriten pa harruar gjuhën e mëmëdheut, ashtu siç e ruajtën për qindra shekuj me radhë arbëreshët e Italisë. Prandaj komuniteti prindëror duhet të tregohet i kujdesshëm në ruajtjen e shqipes. Në demokracinë gjermane askush nuk gëzon respekt se i cilës kombësie je dhe çfarë kontributi ke dhënë, por në radhë të parë është aftësia në fushën e prodhimit dhe shkollimit, prandaj për ne shqiptarët modeli gjerman i shkollës dhe i edukimit është një model që duhet imituar në rrugë origjinale nga shqiptarët mërgimtarë. Nuk duhet të pretendohet të gjendet një zgjidhje–mrekulli, por të bëhet ajo që është e mundur, ajo që varet nga ne shqiptarët. Gjithnjë flitet se hapen shkolla në gjuhën shqipe. Kjo është gjë e mirë, sepse bëhet edhe ndërgjegjësimi i vetë diasporës, për rolin vendimtar që ka sot shqipja e folur dhe e shkruar për fëmi-



Oslo, Athinë etj. Është pozitiv fakti se në shumë qytete në Amerikë, aty ku komunitetet shqiptare janë të organizuar, janë ngritur dhe funksionojnë shkolla dhe kurse në gjuhën shqipe. Po kështu në Kanada janë hapur shkolla shqipe. Në Europë ka shembuj pozitivë të funksionimit të këtyre shkollave si në Zvicër, Gjermani, Suedi, Itali etj., ku funksionojnë shkolla të hapura nga vetë shqiptarët,

gjuhës sonë amtare. Fjala vjen, të mos na duket vetja modern kur në çdo fundjavë me familje kalojmë në njërin prej lokaleve angleze, italiane, gjermane, greke të mos fyhemi nëse flasim në mjedise të tilla familjare në gjuhën tonë të bukur. Kushdo që thotë se jemi shqiptarë, por fatkeqësisht nuk din shqip, ai/ajo s'është më shqipëtar, ndodh që kemi dy bashkëshortë shqiptarë fatkeqësisht fëmijëve të tyre

jet shqiptarë.

Ka vite që në Shqipëri vazhdon hartimi dhe shpërndarja e një abetareje mbarëkombëtare. Efekti i saj në diasporë e gjetkë po ndihet më së miri, shihet se ka një interesim maksimal për këtë tekst të ri të gjuhës shqipe. U bënë vite që është krijuar këshilli ndërakademik Kosovë–Shqipëri, për një shqipe standarde.

(vijon në faqen 13)

Bashkëbisedim me Gazetën “THYMAS”, Media e Institutit për studime Çame

- ÇAMËRIA, KOSOVA, MALËSIA E MADHE, KOSOVA LINDORE,
ILIRIDA, JANË PLAGËT E ÇDO SHQIPTARI -



AGIM DESKU

Ju lutem, më flisni për veten, historinë e familjes suaj dhe jetën profesionale.

Çështjen kombëtare e ka përcjellë çdo gjeneratë si popull, por edhe si poetë, që nga Buzuku e më tej. Janë poetët ata që në një formë janë arma e mbrojtjes së atdheut dhe në çdokohë dhe që kanë treguar se identifikohen me vetë Shqipërinë, atdheun, pra janë çdo herë pararojë. Duke qenë që edhe këmi qenë një gjeneratë që kemi përjetuar dhimbje dhe plagë atdheu, kemi marrë parasyshtënie të bukura poetësh si “Nëse thua diçka të re, e dëgjoj, e lexoj, nëse nuk thua diçka të re, mos fol.” Është një mendim i bukur i një shkrimtari, i cili u kujdes që lexuesit t’i shërbehet diçka e bukur dhe nëse dëshiron vërtet të mbetesh pranë letërsisë, kulturës në përgjithësi duhet të bësh diçka të tillë apo të përafërt. E veçanta e gjithë kësaj është manifestuar tek unë dhe brumosur me “fanatizmin” atdhetarsin nxënës i gjimnazit “Luigj Gurakuqi” të Klinës, ku vija mesimet, herë në këmbë mbi 20 km largësi deri te fshati im i lindjes Siqeva dhe herë me tren. Më pas, shkollimin e lartë për gjuhë dhe letërsi e përfundova në Gjakovë, në vitin 1980, në njëkohë ku retë e qiellit kishin mbuluar Kosovën, siedhe të gjithë shqiptarët që gjendeshin në një trung të ndarë. Përveç të tjerave, një ndër plagët që më rrinte në shpirt ishte edhe Çamëria.

Kur keni filluar të shkruani poezi dhe çfarë ju ka frymëzuar më së shumti për krijimtarinë tuaj?

Në gjimnazin ku luaja disa role të vprave dramatike, gjeta frymëzime poetike, teksa luaja shpirtit rolet që më besoheshin. Ka qenë vepra “Shënime udhëtimi nga Çamëria”, e autorit shkupian Rexhep Zllatku, që më bëri ta njihja këtë dhimbje, e cila menjëherëu bë pjesë e vargjeve të mia, ku dita ditës fillova të botoja poezi në periodikun e Prishtinës dhe atë të Tiranës, sa që vitet e fundit kisha disa cikle poetike me këtë temë dhe për atdheun në përgjithësi. Të them të drejtën edhe skuqesha nga që botoheshin çdo javë dhe madje edhe çdo ditë ndodhte. Kështu, një miku im poet më thotë “mos ke bankën tënde që financon botimin e poezive të tua?”, por në të vërtetë, asnjëherë nuk merrja honorare, madje as nuk paguesha.

Më flisni për botimet tuaja më të suksesshme.

Unë jam mësimdhënës i gjuhës shqipe

dhe frekuentimi i fëmijëve solli edhe botimin e vëllimit poetic, për fëmijë, “Kënga e Pranverës” në vitin 1985. Një vit më vonë doli në dritë vëllimi poetik për të rritur, “Pëshpëritje drite”, ndërsa në vitin 2007 botova vëllimin e tretë për të rritur “Në cilin varg mbes” për të vijuar më tej me vëllimin e suksesshëm “Dua të pi verë Çamërie” në vitin 2011, nga shtëpia botuese “Vllamasi” në Tiranë. Falë përkujdesjes së redaktoreve shumë të nderuar, poetes së talentuar, u bënë edhe 5 promovime, dy në Tiranë (në Dajt e në Durres) dhe në “Kongresin e VIII të Rrjetit të Gruas Shqiptare” mbajtur më 24 nëntor 2012, në kuadër të njëqind vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, duke e falenderuar presidenten Lida Ragami, ku u shpërbleva me çmimin “Mirënjohjesi Personaliteti i Vitit 2012.”

Cila është poezia e preferuar në arkivin tuaj?

Është pyetje e vështirë, por poezia “Çamëria”, që kam fituar çmimin e parë në konkursin letrar nga “Të Rinjtë e Çamërisë”, është shumë e dashur, edhe nga që kjo poezi më dha shumë mirënjohje dhe komente, si edhe e kam modifikuar, si recital poetik, në mënyrë që nxënësit e mi dhe me gjerë, në takime letrare, apo promovime librash paraqesin sa më mirë.

Ju keni fituar disa çmime të para nëpër konkurse letërsie dhe jeni vlerësuar edhe me disa tituj. Mund të na i numëroni ato?

“Nëse thua diçka të re e lexoj, nëse nuk thua diçka të re, mos fol”. Nga ky mendim kam mësuar shumë dhe çdo here jam treguar i kujdesshëm në perceptimin poetik dhe vargëzues të vargut tim, e kam “tjerrur” mirë, kështu që kam pasur edhe komente vlerësuese nga lexues, poetë, miq të fjalës së bukur artistike, duke m’u shpërblyer munda pasi në vitin 2011, në konkursin letrar “Të Rinjtë e Çamërisë”, u nderova me çmimin e parë, ndërsa në vitin 2012, përsëri në të njëjtin konkurs, u nderova me çmimin e parë, “Poet Nderi”. Në vitin 2014, në konkursin letrar, “Flaka e Janarit” në vitin 2014, në Gjilan, nga 360 poezi konkurrese, poezia ime, “Mbrëmje Pavarësie”, fitoi çmimin e parë dhe mirënjohjen “Pena e Flakës”. Në 15 mars të po atij viti, fitova edhe një tjetër çmim të parë në Evropë, në konkursin letrar, “Poezia Del Populi”, në të cilin u nderova me medalje të artë në Milano të Italisë.

Sa rëndësi kanë për ju këto çmime dhe cila prej tyre ju ka bërë të ndiheni më krenar?

Rëndësia është shumë e anshme, duke qenë këta çmime janë fryt i lexuesve të mi të çmuar, i miqve të mi të artit, nxitje dhe shtytje për të vargëzuar edhe më shumë, kështu që të gjitha çmimet për mua kanë peshën e njëjtë të dashur, si dy çmimet nga

“Të Rinjtë e Çamërisë”, si çmimi i “Flakës së Janarit 2014”, ashtu edhe çmimi i Milanos, të cilët i kam në hollin e shkollës ku punoj, të vendosura nga drejtori, një mik i flaktëi artit dhe poezisë sime, z. Nimon Aliu. Këta çmime pasqyrojnë edhe botën time të brendshme dhe më bëjnë të dashur nga kritika dhe shtypi, duke qenë se për to u bënë disa shkrime dhe u dha një publicitet në të përditshmet në Prishtinë dhe Tiranë, në gazetën ditore, Bota sot, Bota Press, Epoka e Re, Nacional, Dielli, Neë Life, edhe në faqet e rrjeteve sociale që redaktojnë poezitë e mia.

Në krijimtarinë tuaj një vend jo të vogël zënë edhe poezitë kushtuar Çamërisë. Cila është arsyeja që i keni kushtuar kaq shumë vëmendje?

I kam kushtuar kaq shumë vëmendje Çamërisë për shkak të dhimbjes që kemi përjetuar nën sundimin disavjeçar të armiqve. Disa lexues nuk e besojnë që vendlindja ime është Kosova, sepse më dinë me origjinë nga Çamëria, madje poetja dhe redaktorja e librit tim “Dua të pi verë Çamërie” më ka thënë “Atë që nuk e bëri politika, e ke bërë ti” dhe ndihem krenar, sepse kështu mund të kontribuoj në shërimin e kësaj plage, pasi kjo është dhimbja jonë dhe duhen zgjeruar idetë së çfarë duhet bërë më tutje.

Më flisni për vëllimin me poezi “Dua të pi verë Çamërie”. Ku u frymëzuar, për një botim të tillë dhe a i ka përmbushur pritshmëritë tuaja?

Më pëlqen një thënie latine “Njeriun e guximshëm e do zoti dhe ka fat, të pagximshëm, as nuk e do zoti dhe as fat nuk ka”. Pa motivin patriotik, asnjë çështje nuk shtrohet në rrafshin e të menduarit për një zgjidhje të drejtë, por është edhe kontributi i poetëve, këngëtarëve, trimave që e duan atdheun të lirë, janë biznesmenët që e ndihmojnë, janë këta zinxhirët harkorë, që një ditë edhe përendia do të na jetë pranë kësaj toke që frymon shqip me mijëra kilometra. Kur në Parlamentin e Greqisë u aprovua se, cila gjuhë do të flitej në Parlamentin e Athinës, fitoi me zor greqishtja, në krahasim me Albanishten çame. Si të mos bëhesh poet, edhe djall dua të bëhem, vetëm e vetëm të jem pranë lotëve të mi çamë. Fatmirësisht, librin “Dua të pi verë Çamërie”, falë guximit që pata për t’i hyrë kësaj teme, çështjen e pazgjidhur të popullit çam e pata në secilin damarë të gjakut tim. Unë pata fatin të njihem edhe me poetin e mirënjohur, miken Znj. Fatime Kulli, një emër i çmuar i poezisë moderne me origjinë çame, të cilën e falenderoj për përkujdesjen e saj si redaktore dhe ideatore. Megjithatë, duhet të falenderoj edhe shkrimet e kritikëve letrarë që shkruan për librin si, Sejdi Berisha, poeti Mikel Gojani, Namik Selmanin, Faik Xhani, Hyqmet Hasko, Prend Buzhala,

Vilson Culaj, Gjon Neçaj, Venka Capaj, Murat Gashi, Andrea Dangli, Fatmira Baboci Rama, Naim Ujkan Prelvukaj-Martini, Plavë. Simbolika e këtij libri është “Pasaporta e Flamurit”, ku e përmend në vargun “Jo, nuk e nënshkruaj kurrë pasaportën time pa mikun çame”, varg ky që flet shumë. E përmenda këtë varg, sepse një lexuese, pasi lexoi librin më shkruajti “Të falenderoj miku im për këto vargje” dhe filloi të m’i recitojë. Më besoni, kur ma shkroi të gjithë poezinë “Pasaporta e Flamurit” mua m’u lotuan sytë, lotuan sytë, sepse për një çast, përjetova diçka shumë të bukur shpirtërore pasi u lumturova kur kuptova se këto vargje kishin senzibilizuar sadopak në një çështje kaq të rëndësishme, siç është çështja çame. Kjo lexuese banonte në Kanada dhe pas saj pasuan komentet e shumta nga të gjitha anët e botës, pasi lexuesit e mi janë ata, për të cilët krijoj vargje për Çamërinë.

Keni menduar ndonjëherë të ndërtoni zhanër letrar?

Jo, edhe pse poeti ynë i dashur, Lasgush Poradeci, e përcakton shumë qartë, që të jesh poet, duhet të lindësh i tillë, për të qenë romancier duhet vullnet për të arritur suksesin, prandaj unë vetveten e gjeta në poezi dhe përmes vargjeve mundohem të jap edhe mesazhe aq të dashura, që janë shpirtërore për mua, aq sa secili lexues e gjen veten aty dhe kryesisht në atë që kemi përjetuar me ndarjen natyrale të një populli. Janë të mallkuar nga Zoti ata që na ndanë, janë të mallkuar ata që e kanë në dorë botën dhe nuk na bashkojnë. Edhe zoti është fajtor, më fal o zot, por kur flas për çamët jam një rebel dhe nuk mund të rri i qetë pa thënë të vërtetën, se nuk ka zgjidhje për paqe në Europë nëse një popull mallkon, edhe pse ne jem ipopull që falim, e duam lirinë, por e duam gjithash-tu atdheun, mbi të gjitha edhe dashurinë e falim, vetëm që atdheu të ndihet i lirë.

E identifikoni fatin e Kosovës me atë të Çamërisë? Ku mendon se çalon çështja çame që nuk po i jepet asnjë lloj zgjidhje?

Çështjen kombëtare e ka përcjellë çdo gjeneratë si popull, por edhe si poetë, që prej Buzukut dhe më tej. Janë poetët ata, që në një formë janë arma e mbrojtjes së atdheut dhe në çdo kohë e kanë treguar se identifikohen me vetë Shqipërinë, atdheun, pra janë gjithmonë pararojë. Çështja e pazgjidhur shqiptare mua nuk më lë kurrë rehat, si Çamëria, Kosova, Malësia e Madhe, Kosova Lindore, Ilirida, janë këto plagët e secilit shqiptar, prandaj kam të drejtë edhe unë në to, prandaj përpiqem të bëj një varg apo një strofë, sepse e meritojnë dhe nuk jam as unë i lire, kur e di sesi ndihen fëmijët, nxënësit që lëvizin të pasigurtë. Eh, nuk kam forcë nga pikat e shiut mbi faqet e mia. Ngecim

Pse të moshuarit bëhen të “vështirë”?

(Psikologjia e moshës)

Anëtarët e familjes, shpesh nuk kuptojnë asgjë, pse ndryshojnë prindit dhe gjyshërit, në sjelljet dhe veprimet e tyre, në familje.

Ju i keni njohur dhe përjetuar prindit apo gjyshërit tuaj, si njerëz të mirë, të dashur, të arsyeshëm dhe të qetë. Tani ata kanë ndryshuar, janë bërë të “vështirë”, nervozë, agresivë, rebelë.

Çfarë ka ndodhur me ata!?

Një gjë e tillë, nuk është rastësi, ka shkaqet e veta, të cilat, duhen kërkuar brenda dhe jashtë tyre. Në të shumtën e rasteve, shkaqet, janë të padukshme madje, të palexueshme dhe të pakuptueshme.

Psikologët mendojnë se, disa nga shkaqet kryesore janë:

- Sëmundjet.

Të moshuarit, shpesh, kanë dhimbje fizike, të dukshme dhe të padukshme. Dhimbjet janë të padiagnostikuara dhe jo lokale por, të shpërndara në gjithë trupin. Shpesh dëgjojmë kur thonë: “Sot më dhemb i gjithë trupi!” Ankesat e tyre, në

shumë raste, nuk merren aspak seriozisht nga njerëzit e familjes. I moshuari, në vend të një fjale ngushëlluese apo dashamirëse dëgjon: “Hajt se i vjetër je ti! Mjaft, se na lodhe tani! Shko vetë tek doktori, nuk kam kohë të merremi me ty!”

Dhimbjet fizike dhe, aq më shumë, kur askush nuk i dëgjon, i bën ata agresivë, deri të paarsyeshëm në sjellje dhe veprime. Dhimbjet kronike, nëse nuk mjekohen, i dërrmojnë dhe i sflitin ata. Nëse, në vend të mirëkuptimit dhe ndihmës, përjetojnë injorimin dhe braktisjen, ndjehen të poshtëruar, të pashpresë dhe reagojnë shumë ashpër.

- Frika.

Frika, në shumë raste, është një shkak shumë i fortë për agresivitetin e tyre. Nuk ka rëndësi nga u vjen frika. Frika tek ata, është frikë. Frika e braktisjes, e vetmisë, se do të përfundojnë në Shtëpinë e të Moshuarve, se do të mbeten në dorën dhe mëshirën e të tjerëve dhe... shumë të tjera.

- Bluarja me mend.

Njëra ndër veçoritë më tipike tek të moshuarit është, bluarja me mend. Ata nuk i ndahen të kaluarës së tyre. Vijimisht e bëjnë “bilancin” e të kaluarës së tyre. Nëse “bilanci” u del negativ, i pushton tër-

bimi, zhgënjimi, mbyten në dëshpërim. Vuajnë nga pagjumësia, shikojnë ëndrra të frikshme, mallkojnë veten, shndërrohen në donkishotistë.

- Anarshizmi politiko-social.

Gjenerata e tretë, e cila, në përgjithësi, është gjenerata e luftës, e punës dhe sakrificave të mëdha, për kombin, karakterizohet nga ndjenja e lartë e patriotizmit. Anarshizmi politiko-social, rrënimi i pasurisë kombëtare, krimi i organizuar dhe korrupsioni, padrejtësitë gjyqësore e helmojnë shpirtin dhe trurin e tyre. Ata nuk mund të pajtohen kurrë me vandalizmin politiko-social. Kështu, që kemi të bëjmë me njerëz me shpirt dhe trurin e helmuar. Shndërrohen në rebelë!

Ata, që jetojnë me prindër apo gjyshër me simptoma të tilla, para se t'i gjykojnë dhe mallkojnë, duhet t'a vënë veten e tyre, në pozitën e të moshuarve “rebelë”. Shkaqet e mësipërme por, dhe të tjera të padukshme, të brenda katër mureve, i bëjnë ata të ndjehen të tepërt në familje dhe



në jetë, e mendojnë veten barrë për të tjerët por, nuk mundin të sillen dhe vepronë ndryshe. Shpesh ia dëshirojnë dhe urojnë vetes vdekjen por, ajo, nuk është vullneti i tyre. Shumë psikologë mendojnë se, moshë e tretë, është “fëmijëria” e dytë.

Çfarë mund të bëni tjetër, ju pasardhësit e këtyre “fëmijëve të vështirë”, veçse t'i pranoni, respektoni dhe ndihmoni ata, ashtu siç janë?

Fëmijët, sipas teorisë së psikologjisë, 83 përqind të shkollimit social, e mësojnë në familje. Fëmijët tuaj, në të ardhmen, do të sillen me ju, ashtu siç silleni ju me prindit dhe gjyshërit tuaj.

Nëse nuk dëshironi t'ju braktisin pasardhësit tuaj, mos i braktisni paraardhësit tuaj! Ftoni në tavolinë dhe festoni bashkë! Gëzuar 2024!

LEKË IMERAJ

shkrimtar, përkthyes e publicist

◀ në kërkimin e ideve të përafërta me miqtë ndërkombëtarë, duke sensibilizuar me shumëforma të ndryshme, me përkthime, pse jo në gjuhën angleze, italiane, gjermane, franceze dhe çmimi që fitova në Milano ishte falë poezisë së përkthyer në italisht nga nje mike imja, sepse bota lexon atë që ne i shërbejmë dhe ato që ne përkthejmë çalojnë, gjë që kushton shumë, prandaj mesazh im është që të përkthejmë për këtë plagë, në mënyrë që botës demokratike t'i themi: “Ja, kjo është dhimbja e ndarë në dysh nga Evropa”.

Cilat janë projektet tuaja profesionale? Keni ndonjë botim tjetër në dorë? Më flisni për të?

Është një përjetim dhe privilegjitë jesh i ftuari në “Kongresin e Rrjetit të Grave Shqiptare”, që u mbajt në Vlorë, më 24 nëntor

2012, ku u kurorëzova me çmimin “Personaliteti i vitit 2012”. Më ftuan të nderuarat, presidentja zonja Lida Rragami dhe Emine Kica, koordinatorjae këtij Rrjeti, që plot dashamirësi vëllazërore shfrytëzoj rastin t'i përshëndes dhe t'i falënderoj për ftesën dhe për pritjen, që më bënë, ku u fol për çështjen e pazgjidhur Çame. Ishte një kënaqësi e dyfishtë, kur zonja Lida në foltorene Kongresit më prezantoi dhe më bëri komplimente si poeti më i mirë që shkruan për Çamërinë, ku njeriu ndihet shumë mire kur dëgjon diçka nga të tjerët për punën tënde. Të gjithë mendonin, se jam çam, por nuk mund të mos ju them se “Po, jam sepse e kam shpirtin çam”. Në atë Kongres përjetova edhe një kënaqësi shpirtërore, vëllazërore, miqësore, duke qenë se aty edhe më shpërblyen me çmimin “Personaliteti Vitit 2012”. Për mua

ishte një nderim i veçantë, një shtysë për të shkruar edhe më shumë dhe më besoni, kur kam shkruar në shtëpi, i mblodha edhe poezitë e tjera që kisha krijuar sërish për Çamërinë, saqë më rezultuan 150 poezi edhe për njëpërmbledhje tjetër vetëm për çështjen çame, është e dyta në radhë dhe të gjitha janë botuar nëpër gazeta si në Tiranë, në Prishtinë, te ‘Dielli’ në Boston, te “Neë Life”, e të tjera. Këtë përmbledhje, vëllim të dytë e pagëzova më titullin, “Vargje që sjellin lotë Çamërie”, edhe ky një moment i sensibilizimit të çështjes çame dhe uroj me shpirt që të dalë në dritë sa më shpejt, ku le të mbetet edhe befasi për lexuesin pasi në janar do të botohet nga miqtë e mi në shtypin e Tiranës.

Në fund dua të shtoj se janë lexuesit e shumtë të poezive të mia që më japin kurajo dhe guxim që të vijoj edhe në të

ardhmen t'i përkushtohem edhe më tepër çështjes çame. Këta lexues, zakonisht i gjen edhe në rrjete të ndryshme sociale të facebook-ut, ku zakonisht publikoj herëpashere botimet e mia dhedo të doja ftoja t'i lexoni edhe ju dhe lexuesit e tjerë të revistës suaj, që e duan fjalën e bukur poetike, nëse dëshirojnë të njihen më mirë me krijimtarin time, e cila kryesisht i kushtohet Çamërisë sonë të bukur dhe atyre njerëzve, të cilët kanë nevojë më shumë se kurrë të ndihen të paharruar nga trunghi i tyre shekullor.

Epitetet e ndryshme që më jep lexuesi si “poet që i shëben çështjes kombëtare”, “poet i Çamërisë, ti ke lind në Çamëri, me shpirt e me vargje” dhe shumë të tjera, më bëjnë të ndihem mirë dhe njëkohësisht të vijoj rrugëtimin tim edhe në të ardhmen.

(vijon nga faqja 11)

Të dy akademitë, duke pasur parasys se gjuha shqipe është tipari kryesor i kombësisë shqiptare, mjeti themelor që siguron ndërlidhjen shpirtërore ndërmjet hapsirave e vendeve shqipfolëse, synojnë që zotërimi dhe përvetësimi i shqipes standarde të jetë objekti themelor i brezave të sotëm.

Shpresojmë që Këshilli Ndërkademi do të merret si gjithnjë me vrojtimitet dhe vlerësimet e politikave gjuhësore për ta bërë shqipen tonë një gjuhë mbarëkombëtare, sepse emigracioni ndërkombëtar shqiptar është shpërndarë në Greqi, Itali, Gjermani, Mbretëri e Bashkuar, Belgjikë, Francë, SHBA, Kanada, Zvicër, Suedi, Austri etj. Janë më shumë se 1/3 e fëmijëve që jetojnë e mësojnë shqip në këto vende.

Me gjithë predispozitën e prindërve për të kontribuar në ngritjen e shkollave apo për të hapur klase për mësimin e gjuhës amtare, ende ka probleme në këto vende. Është emergjente të kërkohet legalizimi në rrugë shtetërore për nisma të veçanta, që duhet ndërmerren dhe

kërkohet të mendohet nga organet kombëtare të hapen dhe funksionojnë shkolla si në vendin tonë, ashtu edhe në vendet e tjera, ku kërkohen të ngrihen këto shkolla për mësimin e shqipes. Nëse ne shqiptarët bëjmë të pamundurën për ruajtjen e gjuhës shqipe, edhe shteti shqiptar të programojë diçka të frytshme pra, të organizojë dhe të drejtojë veprime drejt rrafshimit të dallimeve të krijuara si pasojë e ndarjeve politiko-administrative, që sjellin jo pak vështirësi në komunikimin kombëtar, atëherë gjuha jonë do të zërë vërtet vend të nderuar mes gjuhëve të tjera europiane. Vetëm kështu u vijnë në ndihmë në ruajtjen e gjuhës shqipe fëmijëve shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë. “Shkolla” e familjes mërgimtare për mësimin e gjuhës shqipe, kërkon veç të tjerave të mbështetet më mirë nga politikat arsimore shtetërore me mësues e programe shkencore. Me të drejtë preokupohemi për analfabetizmin funksional në sistemin tonë arsimor, por çëmër t'i vëmë atyre dhjetëra qindra fëmijëve shqiptarë, që ende vetëm e belbëzojnë gjuhën shqipe, pa lë të njohin historinë, kulturën, gjeografinë

dhe traditat e këtij kombi. Kësaj drame duhet t'i jepet fund! Shumë përgjegjësi kanë intelektualët shqiptarë që jetojnë dhe vepronë në emigrim. Ata duhet të jenë më aktivë dhe më krijues në organizimin sa më efektiv të kurseve, shoqatave dhe shkollave për mësimin e gjuhës amtare. Mërgimtarë shqiptarë, flisni me fëmijët shqip në familje, se vetëm kështu mund të ruhet gjuha e mëmëdheut.

Indiferentët, dembelët dhe ata që nuk vazhdojnë rrugën që hapën Rilindësit tanë, historia do t'i dënojë dhe shoqëria njerëzore do të mbajë qëndrim kritik ndaj tyre. Nga Bostoni i Amerikës, Konica, para shumë vitesh, do të shprehej: “...Erdhi më në fund dhe për gjuhën shqipe koha e lulëzimit, koha plot shpresë! Me të katër anët, një zjarr i bukur zien në zemër të djalërisë dhe, plot me dëshirë, trimoshët e dheut tonë po përpiqen për zbulimin e shqipes. I vlerësojmë, i pranojmë dhe i respektojmë vlerat gjuhësore e kulturore të popujve të tjerë. Dhe respekti për të tjerët ka vlerë e besueshmëri, kur në radhë të parë respekton vlerat e kombit tënd...!”

Vite më parë, në Universitetin “Luigj

Gurakuqi” të qytetit të Shkodrës, që u organizua seminari i XII mbarëkombëtar me temë “Për mësimin plotësues të gjuhës dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, ku morën pjesë mjaft gjuhtarë nga trojet shqiptare dhe diaspora, ku u shtrua problemi i përmirësimit të modeleve të mësimdhënies në shkollat shqipe në mërgatë si dhe shkëmbimi i përvojave në këtë fushë. Qeveria shqiptare ka vullnetin për të plotësuar detyrimin ndaj fëmijëve të emigrantëve, që ata të mësojnë gjuhën shqipe dhe kulturën kombëtare. Gjuha amtare përbën shenjën e parë të identitetit kombëtar, si e tillë ajo duhet mësuar dhe zhvilluar...”.

Vetëm kështu e mbajmë gjallë gjuhën shqipe tek fëmijët mërgimtarë, duke ngulmuar më shumë se deri tani për të sotmen dhe vetëm kështu shqiptarët do të jenë të denjë për të hyrë në familjen e madhe europiane, duke i shërbyer të ardhmes së brezave të rinj përmes fjalës së bukur shqipe. Mesazhi im do të ishte: “Shqipëtarë, kudo që të jeni, jeni krenarë që flisni shqip, vetëm nëse e ruajmë gjuhën shqipe kudo që jemi, mbetemi përherë shqipëtarë.

BUJARIA TROPOJANE TRADITË HISTORIKE E SHQIPTARISË

SFIDAT E NJË POPULLI NËN PESHËN E DHUNËS



Profesor Dr. Tahir Bezhani

Vitet 90-ta të shekullit të kaluar, për popullin shqiptarë në Kosovë, dhe mbarë shqiptarët kudo, do mbetin të shkruara në faqet e historisë, si ndër vitet më të vështira brenda një shekulli, që nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912. Që nga shkëputja nga trualli amnorë i Shqipërisë dhe mbetja nën sundimin e titistëve Jugosllav, kulshedra sllaviste e Karpateve, gjithnjë e gjithmonë, me qëndrimet e saja hegemoniste, e te mykur kokash nga shovinizmi, gjatë gjithë historisë së tyre shekullore, iu vërsulen një populli të pafajshëm në trojet e veta etnike. Pasionet e hegemonisë sllave gjatë tërë shekullit të kaluar, ishin të stërngarkuara me veprime gjenocidiale, ndjekëse e shfarosje deri në pakufi.

Janë të ditura tani më, shumë elaboratë e plan programe, pa dashur t'i numërojmë këtu rast, realizatori i fundit i hegemonisë serbe, shoveni i çartur e kasapi i Ballkanit, Sllobodan Millosheviqi, tentoi që në vitet 90-ta të "përmbaroj amanetet" e trashëguara nga mësuesit e tij shoven. Përkundër të gjitha veprimeve monstruoze që ndërmoi në vitet 90-ta të shekullit të kaluar, duke krijuar një apartheid në truallin e Kosovës në të gjitha lëmit e jetës, fatbardhësisht nuk ia arriti qëllimit për ta zbratur Kosovën përgjithmonë. Mendoj se në këtë kuptim, luajtën rol të madh dy fakte esenciale të kohës: e para se shqiptarët e Kosovës nuk ishin ata të viteve 40-ta, te pa shkolluar e te paditur, por tani, dija universale kishte përfshi çdo shtëpi, çdo familje, falë shkollimit të viteve 70-ta; dhe fakti tjetër e absolut, ishte se në ballë të popullit dolën njerëz akademikë të spikatur, te shkolluar brenda e jashtë vendit, te cilët, të brumosur me dije universale evropiane, ditën mirë ta drejtojnë popullin drejtë qëllimit-lirisë e pavarësisë së vendit. Në ballë të furtunave të kohës, me shume shokë, u gjend urtaku i popullit i cili me mençurinë prej një burrështetasi te madh, e bëri popullin "grusht" për t'i rezistuar ashpër e vendosmërisht, si kurrë më parë, hegemonisë serbe.

Ditët e muajt kalonin nën tronditje të vazhdueshme në ato vite të mizershme të viteve 90-ta, ndera reprezaljet shtoheshin çdo ditë e më tepër. Rrahjet, burgosjet, përndjekjet, dënimet në forma të ndryshme për çkado e asgjë, deri te vrasjet, ishin përditshmëri e kohës së atyre viteve. Çdo ditë që kalonte, ishte një hap drejt

ndezjes së luftës së imponuar nga policia dhe politika hegemoniste e Serbisë. Durimit i kishte ardhur fundi. Nuk jetohej më nën atë presion të mizërisë nën tutelën e Serbisë. Rinia shqiptare kosovare, filloi të shfaq reagimet dhe mosdurimin, duke u organizuar në grupe guerile për kundërvënien. Liri o vdekje sillte koha. Në pranverën e vitit 1998 plasi lufta, u ndez në disa vende. Filloi me Gllloxhan, Smolicë e Shqiponjë, dhe shumë shpejtë përfshiu tërë Kosovën. Të lodhur nga padrejtësitë dhe represaliet e politikës shovene Serbe, aksioneve dhe luftës iu përgjigjen e gjithë rinia kosovare, pastaj i gjithë populli. Qershori i vitit 1998 ishte kulminacioni i luftës, gjakderdhjes për lirinë e Kosovës....

PARAPËRGATITJET PËR LUFTË BËHESHIN NË FORMA TË NDRYSHME....

Reka e Keqe, e tëra, me njëzet e katër fshatrat e saj, ishte përfshi nga lufta. Zjarri i luftës ishte i tmerrshëm në çdo fshat. Granatimet e policisë e ushtrisë Serbe nga largësia kishin mbjellë pasiguri e tmerr të popullatës. Problem kryesor në ato momente të rënduara sillnin familjet, fëmijët, branimit dhe pleqtë e moshuar, të cilët nuk mund të ishin kontributdhënës në situatat që vinin... Për këtë qëllim, filloi edhe emigrimi i familjeve brenda fshatrave për rreth të Rekë së Keqe. Por, me që lufta përhapej me shpejtësi të paparashikuar, banorët menduan alternativa të tjera. Me organizime të llojllojshme, ia mësrynë Shqipërisë, pikërisht Tropojës legjendare, ku gjetën strehim me mijëra familje kosovare nga e gjithë Reka e Keqe e jo vetëm. Kjo zonë kufitare me Shqipërinë, (Tropojën), kanë pasur gjithmonë një histori të veçantë me lidhje farefisnore. Secili përpiquej të gjente të vetin për t'u strehuar në atë situatë krize.

Ndonëse kohë e gjatë ka kaluar, mbi njëzet vite, por njerëzit gjërat e rëndësishme të veçantë e jetike, nuk i harrojnë kurrë. Njëri nga protagonistët e atyre ngjarjeve historike e të pa harruara, ishte edhe Rexhë Daut Arifi nga fshati Pacaj i komunës së Gjakovës, i cili pa pritëse, por i nostalgjuar, na rrëfeu ditët e rënda të ikjes nga lufta dhe qëndrimin në Tropojë të familjes së tij e disa kushërive, së bashku.



Rexhë D. Arifi, (djathtas), nga fshati Pacaj-Gjakovë, rrëfen ngjarjet e luftës të viti 1998-1999

Me Rexhë Arifin u takuam dhe ndenjmë në Junik, pas një kohe të gjatë. Kur iu luta të rrëfejë për ngjarjen e kohës së ikjes me familje në Tropojë, ai disi, si i zënë piskë, u skuq në fytyrë, fërkoj duart e rrudhura e te lodhura nga mosha dhe filloi, si i përlotur:

Po-tha! Po të tregoj fill e për pe!... Askush, pos teje, deri me tani nuk më ka pyetur për ato ditë aq të vështira të jetës sonë. Dëgjo e shkruaj, më tha!...

Në fillim qershor të viti 1998 lufta kishte përfshi tërë regjionin e Rekë e Keqe, edhe këtë të Lugut të Çarragojës ku gjendet fshati ynë, Pacaj. Kishin ikur familje nga fshati Botushë, e disa fshatra tjera e ishin strehuar në fshatin tonë, Pacaj. Duke parë rrezikun e familjes por edhe pengesën për të luftuar për lirinë e shumëpritur, një mbrëmje u tubuam dy-tri familje të afërta, kusherinjë dhe biseduar për shpëtimin e familjeve. Gjetëm derdalje me Hisen Arifin, tani dëshmorë i kombit, dhe të nesërmen, siguroam një traktor për transport deri në Junik, te lagja Gacafer. Nuk më kujtohet data e saktë e ikjes, por e di që nga fshati jonë u nisem në ora 14-të të ditës, duke planifikuar kohën e kalimit të kufirit natën. Në shtëpi te Hisenit kishin ardhur edhe dy-tre familje nga fshatrat tjera ishin strehuar përkohësisht. Së bashku të gjithë, familja e Hisen Arifit, Rexhë Arifit, Rexhep Dinës (nga Botusha), Bajram Salihut (nga Morina) dhe e Sali Tahirit (nga Ponosheci), kaluam nëpër disa rrugë të zorshme deri te lagja Gacafer në Junik. Aty zbritem nga traktori dhe morëm drejtimin e shpateve të fshatit Gjocaj e Jasiq, kah bjeshka e Babaj të Bokës, në drejtim të Shqipërisë.

Gjatë gjithë këtij udhëtimit të gjatë, të lodhshëm, me shumë sfida e mërzë, fati e deshi që të kalojmë kufirin pa asnjë rrezikshmëri te lartë. Kishim në këtë udhëtim katër fëmijët (tani) të dëshmorit Hisen Arifi të moshës 4 deri në shtat vjeç, katër nëna të moshuara mbi gjashtëdhjetë vjeç, por asnjë ankesë nuk u paraqit, asnjë vaji fëmijësh, udhëtim i heshtur plotësisht. Me vete kishim furnizim me ushqime, uji pinim burimeve të bjeshkës. Nuk dëgjuam e as nuk hetuam zënie pritash buzë kufirit nga ana e ushtrisë e as e policisë Serbe. Zaten, ia kishin frikën edhe vet të ofroheshin buzë kufirit nga pjesëtarët e UÇK-së, të cilët ishin në lëvizje ditë e natë në bartje të armatimit nga Shqipëria.

Në këto rrethana udhëtimit, të sflitur nga lodhja, kishim marë drejtimin e pikës kufitare me Shqipërinë e cila quhej C-2 - shi . Aty u gjendem pikërisht rreth orës tre të pas natës, (mëngjesit), kur kaluam andej dhe morëm drejtimin e Tropojës së vjetër. Karshi nesh filloi dukja e majës së Shkëlzenit si një gjigant i madh. Tani e shikonim

si një mburojë tonën. Në një lëndinë të bukur, rrethuar me ca qetina të shkurtra, vendosem të pushonim. Ishim të shumë të lodhur. Fëmijët kishin "harruar" të flisnin nga lodhja, nënplakat ofshanin thellë nga lodhja e mërzia e ikjes nga shtëpitë e tyre. Pas një çlodhje të vogël, morëm sërish rrugëtimin. Nata kishte filluar t'ia lëshonte vendin ditës. Anise nuk dinim se edhe sa kohë na duhej udhëtim deri te caku. Befas u gjendem në Tropojën e vjetër. Kishin filluar lëvizjet e banorëve vendas atë mëngjes të hershëm. Na uronin "mirëseardhje", dukë na shikuar me dhimbje e dashuri te madhe. Sytë e tyre përloreshin menjëherë. Tani vijnë e ju marrin-na thonin disa! Dhe vërtetë, sapo mbërrimë në qendër arriti një makinë transportuese. Hipni në makinë-na tha shoferi! Qenkeni shumë të lodhur!...

Me atë makinë shoferi na drejtojë drejtë fshatit Margegaj. Ishte një shkollë aty afër, ngjitur për qytetin Bajram Currit. Aty zbritem të gjithë. Këtu pritni, vijnë e u marrin-na foli shoferi të cilit nuk ia ditëm kurrë emrin. Ai u kthye në punën e tij të përditshme. Sigurisht se bante refugjatë tërë ditën nga Kosova. Kështu menduam ne!...

Nuk qëndruam gjatë afër asaj shkolle në Margegaj, shpejtë erdhën disa qytetarë dhe na morën në shtëpitë e tyre për strehim. Në fytyrat e tyre dukej shqetësimi e dhimbja, por edhe dashuria e respekti pa kufij. Askënd nuk e njihja-thotë Rexha. Në këto çaste u ndamë mes veti, pas një rrugëtimi të gjatë e shumë të mundimshëm.

Hisen Arifi me familjen e tij shkoi te tezaku i nën Zade, Adem Lushaj nga Padeshi i cikli jetonte në bajram Curri. Unë (Rexha) u strehova në familjen e Arif Nezirit në Margegaj. Bajrami e të tjerët nuk e di se ne cilat familje shkuan, por e di se për një kohë të shkurtër ishim strehuar të gjithë. Kushdo që tenton të përshkruaj mikpritjen, bujarinë, respektin e dashurinë e vëllëzërve tropojanë të atyre viteve të rënda, e ka të pamundur që t'i thotë të gjitha. Ato vite mbetin hallkë hallkë lidhëse e përjetshme e vëllazërore me qytetarët e gjithë Tropojës.

PASAKOMODIMIT TË FAMILJEVE, KTHIMI NË ZONAT E LUFTËS

Pushuam tri dite e net në Tropojë, bashkë me familjet tona, në shtëpitë e vëllëzërve tropojanë. Pas tri ditësh, u kthyem në Kosovë, të njëjtës rrugë, dhe menjëherë vendosem të futeshim nëpër njësi luftarake në luftë për lirinë e atdheut. Në grup ishim: Hisen Arifi, Rexhë Arifi, Ylber Arifi, Musa Arifi, të gjithë kushëri. Bashkudhëtonte me neve edhe Ilir Zenun Gaxherri nga Juniku. Prijësi e ideatori e gjitha këtyre lëvizjeve ishte Hisen Arifi. Ai na printe kudo në aksione për lirinë e vendit tonë të okupuar nga forcat Serbe.

Lufta zhvillohej me ashpërsinë e çmendur në tërë Kosovën. Në altarin e

lirisë binin çdo ditë djemtë e Kosovës martire. Jeta nuk kishte vlerë karshi lirisë e robërisë nga Serbia. Hiseni kaloi në avisionim me grade ushtarake dhe komandoi njësinë e tij në luftë. Ishte i patrembur. Shpesh u gjend ballaballë zjarrit të forcave Serbe. Ishte e kobshme data e 25 korrikut 1998 kur në Kallavaje të Junikut u godit nga tanku i ushtrisë serbe. Ishte së bashku me luftetarë tjerë kur u plagos rëndë për vdekje. Nga pjesëtarët trima të luftës, u nxor nga vija e zjarrit dhe u dërgua në spitalin ushtarak të Irzniqit. Iu bëri ballë plagëve përafërm dy javë. Kur dëgjonte krismat e tytave të armëve duke vjellë zjarr në vija të frontit për lirinë e Kosovës, Hiseni u thoshte shokëve ne shtratin e vdekjes:” dëgjoni sa të bukur janë tingujt për lirinë e Kosovës!...” Vdiq me 9.gusht.1998. U rivarros pas lufte në fshatin Sheremejat, afër shkollës ku kishte dhënë dije gjeneratave te reja në kushte tejet të vështira në vitet 90-ta.

Familja e dëshmorit Hisen Arifi, e cila ishte e strehuar në familjen e Adem Lushaj në bajram Curri, me te marë lajmin e kobshëm për vrasjen e Hisenit, hapen derën për të pame sipas traditës, ku morën pjesë qindra tropojanë. Në fytyrat e tyre vërehej dhimbja e pa përshkruar. Nënë Zadjja dhe bashkëshortja Sanija, e mbajtën veten si dy malësore sojnikë, karshi një dhimbje të madhe shpirtërore. Dhimbja familjare ishte bërë njësh me dhimbjet e tropojanëve.....

EKSODI MASIV DHE VDEKJA QË SHIKOHEJ ME SYTË E LIRISË....

Lufta kishte përfshi çdo skutë të vendit në flakën e barotit. Familjet që kishin lëvizur nga një vend në tjetrin, tani kishin mësy qytetin për t'u strehuar. Shumë banorë të Rekës së Keqe ishin strehuar nëpër shtëpi të gjakovarëve, te cilët kishin treguar një mirëkuptim dhe respekt të jashtëzakonshëm për banorët nga zonat e luftës. Presioni i policisë e ushtrisë serbosllave ishte i pamëshirshëm. Shumë fshatra ishin djegur e bërë rrafsh me toke. Vrasje të civilëve rrugëve të fshatrave e skutave të qytetit kishte çdo ditë, pavarësisht moshës, e besa edhe gjinisë.

Kulminacioni i represionit përmes formave të dhunës fizike, duke i vrarë, rrahur, grabitur e plaçkitur, si mënyrë e dëbimit sa më të shpejtë nga trojet e tyre, u arrit në vitin 1999,pas bombardimit të Aleancës së NATO-s ndaj caqeve të forcave serbe.

Pas kësaj date filloi kallja e qytetit të Gjakovës, e kallen Çarshinë e Madhe, disa lagjet periferike, filluan vrasjet natën

nëpër shtëpi, thënë me një fjalë, filloi kryerja e gjenocidit masiv ndaj popullatës civile e të pambrojtur nëpër shtëpitë e tyre. Këtë gjendje trishtuese e gjenocidiale e përjetuan me mija familje të pafajshëm. Jeta e tyre ishte shndërruar “mish për top,” si thotë fjala popullore. Iket për në Shqipëri ishte e vetmja derë shpëtimit.

Në këso rrethanash trishtuese gjendej atëbotë edhe familja njëmbëdhjetë anëtarëshe e Muharrem Z. Bezhanit nga Smolica, Rekë e Keqe, e cila kishte kaluar disa muaj jete të vështirë nga fshati në fshat, e së fundmi, ishte strehuar në familjen Malush Komani, në Gjakovë.

Vitet kanë ecur binarëve të vet, ndërsa shumë njëjës, përjetues të atyre ngjarjeve monstruoze, kanë vdekur, si në rastin e



Hekuran Bezhanit, rrëfimtari i ngjarjeve të luftës, 1999, eksodi

personit të lartcekur, i cili që nga viti 2014 nuk jeton më. Por, fëmijët tija, tani të rritur, mbajnë mend fare mirë gjithë atë kalvar të përjetuar nga mynxyrat e një politike shovene të Serbisë. Për këtë qëllim edhe intervistua Hekuran Muharrem Bezhanin nga fshati Smolicë, i cili kishte vetëm shtatë vite jete kur familjarisht përjetuan tmerret e luftës që kurrë nuk harrohen, sikur të jetonte dyqind vite.

Nga mbamendja tejet e freskët e Hekuran Bezhanit, tani tridhjetë vjeç, shënuam përjetimet më eklatante të asaj kohe të eksodit dhe qëndrimit në Tropojë, deri në mbarimin e luftës.

Hekuran Bezhanit:

TROPOJANËT NDANË ME NEVE EDHE KAFSHATËN E GOJËS

Më kujtohen fare mirë ato ditë të tmerrshme të luftës, anise isha vetëm

shtatë vjeç. Banonim në Gjakovë, në shtëpinë e Malush Komani, afër gjykatës, një lagje e stërmbyshur me të shpërngulur nga shtëpitë e tyre. Ishim njëmbëdhjetë anëtarë të familjes. E mbaj mend sikur sot, kur mesnatën e fundit të marsit 1999,ndëgjua krisma të forta në derë të oborrit. Për fatin tonë, gjyshja e kishte mbyllur derën me rezen e hekurit të fortë dhe nuk hapej lehte, anise, rrallë e mbyllnim. Duke shikuar përmes dritareve pa drita, hetuam se ishte policia serbe, nga se dëgjoheshin piskamë edhe në shtëpitë tjera të afërta. Pa hezitim baba na ftoj në katin për dhese. Në podrumë të shtëpisë gjetëm një çekan të rëndë, afër 5 kg. me të cilin thyem, me radhë murin e dhomës për dhese, hapem një vrimë për dalje dhe kaluam në oborrin e fqinjëve, ana e kundërt e rrugës. Aty gjetëm edhe shumë banorë të tjerë. Atëbotë unë nuk i kuptoja të gjitha bisedat që bëheshin, sepse ishim të stresuar tej mase, por e di se brenda një kohe jo të gjatë, të gjithë u gjendem në rrugë, si karvan i humbur stuhive e në heshtje, ecnim drejtë kufirit me Shqipëri, në kahen e Qafës së Prushit. Moti ishte i ftohtë, binte shi. Baba e gjyshja ishin te vjetër, por edhe të sëmure. Ne fëmijët, ndihmonim herë njërin e herë tjetrin. Rrugës, buze malit, vërenim njerëz të vrarë. Nga lodhja e tepërt, kishin hedhur gjësende anash rrugës, nuk mund i banin nga lodhja. Bile, e di mirë, unë gjeta një xhup të mire, të cilën e vasha dhe shpëtova nga të shiu dhe të ftohtit.

Policia serbe lëvizte me makina rrugës. Ndalte njerëz të rritur, legjitimonte, ndante nga familjet... Ne kishim ulur kokën, shikonim vetëm ku venim këmbën. Më në fund, tejet të rraskapitur, arritëm në Qafë Prush, pika kufitare me Shqipërinë. Aty na legjitimuan, letërnjoftimet dhe dokumentet identifikuese i asgjësonin. Pasi kaluam kufirin, pamë se pritshin shumë njerëz për të marë në strehim. Vëllezërit shqiptarë ishin me makina. Patëm rastin e fatin e mirë të na strehojnë në një familje në fshatin Letaj, jo fort larg kufirit. Kanë kaluar shumë vite dhe emrin ua kam harruar, por me gjasë edhe mbiemrin e kishin Letaj. Na ofruan të gjitha të mirat në shërbim, nga ushqimi deri te akomodimi në dhoma të fjetjes. Kjo familje ndante kafshatën e gojës me neve. Ishin të shqetësuar aq sa ishim edhe ne që kishim përjetuar golgotën e jetës. Shprehnin dashur, dhimbje e respekt në çdo moment. Në Letaj qëndruam vetëm dy net. Nga aty na dërguan për Bajam Curri ,me sig-

uri për kushte më të mira, apo për radhën e të tjerëve, nuk e dija. Me një mjet transportues nga Letaj, udhëtuam drejt bajram Curri. Kur shkuam në Bujan, baba këmbënguli të ndalemi të Rexhep Buçpapaj, ishte tezaku i baba, nënat motra. Nuk ishin takuar kurrë. U ngrykuan me shumë mall e lot. Aty u strehuam për dhjetë ditë. Vërejtëm se tezaku i baba, Rexhepi, pos kushteve tejet të rënda ekonomike, vuante edhe nga sëmundje të ndryshme. Kishte një pamje të dobët fiziku, por një zemër të madhe bujare sa vet Shkëlzeni. Megjithatë ndërruam vend, shkuam në Bajram Curri, në shtëpinë e bujarit me zë, Imer Hoxha, i biri i Rexhep Hamzës, në lagjen 28 gushti. Ky burrë i njohur e shumë bujarë, na priti e mbajti si ishte më së miri, me të gjitha gjërat e mundshme për jetë, me shumë korrektësi.

Ata njerëz,(tropojanë),të gjithë si një, në ato rrethana të kohës së përgjakshme, me ne ndanin varfërinë e tyre, ndanin dhimbjen dhe dashurinë gjakësore , njerëzore e humane, në çdo aspekt të jetës. Përshtypjet nga e gjithë ajo mirësi, bujari e korrektësi prej vëllezërve të një gjaku, duhet t'i shërbejë të gjitha kohëve, historisë, si shembull tipik se si përballohen punët e rënda të bashku, të përfaquar e në mbrojtje të njëri tjetrit.

Pas tre muaj, sërish me transporte të vëllezërve tropojanë, u kthyem në shtëpitë tona, në Kosovën e lirë, në korrikun e viti 1999. Nuk shkuam drejt në fshatin e lindjes, Smolicë, nga se asgjë nuk kishte mbetur nga flaka e tymi, nuk kishim ku të fusim kokën. Bëmë dy net në hapësirë, nën najlon e plafa të falur. Pastaj shkuam në Botushë, te familja e dajave, por edhe aty çdo gjë dukej e shkretuar nga tymi e flaka. Gjithë vendit i vinte era vetëm shkumb e hi. Druanim edhe nga minimet e shtëpive!... Ishte rritur bari, ndryshuar e gjithë pamja e fshatit, saqë me zor e njihje vendin tënd.....

Por, dashuri për vendlindjen, puna dhe atdhedashuria, për çdo ditë ia rikthenin buzëqeshjen e vrarë atdheut e vendlindjes se kallur nga barbaria shekullore e një armiku gjenocidbërës.

Jeta vazhdon! Historia nuk duhet harruar, që të mos përsëritet e keqja kurrë më!....

Gjakovë,
me 10 dhjetor 2023

PRELË SHYTANI, ATLET KULTURE

PROF. PRELE SHYTANI, INTELEKTUALI BURRË, ELTARI E KRENARA JONË DUKAGJINASE!

Dukagjini gjithmonë elitar!

Unë, me prosor Prele Shytani jam njohur qysh kur isha 14 vjeç dhe takoheshesim rregullisht natën e Shqurkut te miku im (dhëndrri) Pal Nika, vërtetë një burrë i rregullave dhe i bisedes për festë, por edhe komunikimi i lezëçem me shakatë e tij e kthente Trevezën në festare.

Profesor Prelë Shytani sot 76 vjecar, në pension dhe shumë i fortë e vital, ishte një mësues ekselent, mësimsdhënës i shkëlqyer, komunikativ me nxënësin dhe prindin, por shumë aktiv bashkëpunimi me bashkësinë kudo në Dukagjinë e më gjerë,

kjo e lartëson si burrin intelektual e missionar në komunikimin që sillte duke promovuar kulturë e harmoni mes njerëzve.

Pas viteve "90-të jemi takuar gjithnjë më shpesh, unë herë pas here e ngacmoja Prelën, mikun tim, në bindjet politike, por kurrë Prelë Shytani nuk armiqësohej, përkundrazi më argumentonte, duke qeshur e duke lënë hapsirën e kënaqësisë për tu takuar sa më shpesh.

Aktiv me shoqatën atdhetare “Dukagjini”, që është nje nder themeluesit e pare të saj, aktiv me publikun, personaliteti që ka botuar plotë artikuj në gazetën “Dukagji-

ni”, Euro Albania e të tjera, kjo sipërmarrje tjetër përballë lexuesit, por gjithmonë i përshëndetur nga elita.

Vërtetë kemi një intelektualë burrë, përballë të cilit shkemben mendim secili, madje unë edhe kam mësuar përballë tij, duke konsideruar atlet kulture në gjitha dekadat.

Uroj për profesor Prel Shytani, qoftë jetëgjatë e shëndet plotë!

Profesor Prele Shytani
e gazetari Agron Përbibaj

AGRON PËRBIBAJ



*** Poezi nga Gjystina Lumaj *** Poezi nga Gjystina Lumaj *** Poezi nga Gjystina Lumaj ***

DASHURIA*Kushtuar Shën Valentinit*

Dashuria ka një emër,
Dashuria ka një jetë,
Dashuria ka një zemër,
Dashuria s'ka sekret.

Buzët ngjiten përmbi faqe,
E në shpirt ti diçka ndjen,
Një arom prej manushaqeje,
Tek dashura patjetër e gjen.

Dashuria jo nuk ka gojë,
E shpirtit tan ajo i flet,
Dashuria nuk është lojë,
E nga brënda ty të pëlçet.

Dashuria është si një ujëvar,
Rrjedh e rrjedh pa pushim,
Përherë çelë margaritar,
N'çdo zemër ka një kuptim.

Dashuri ka me mijëra,
Po zemra veç një pranon,
Dashuri është vetë jeta,
Dhe askush pa të s'jeton.

PAVARËSI-GJITHMONË E JONA*17 Shkurti - Pavarësis së Kosovës*

Ishte e djelë-data shtatëmbëdhjet,
Një shqiptonë për ne lindi përjet.
Emri i sajë është Pavarësia,
Gëzon Kosova e gëzon Shqipëria!

Me gëzim shqiptart e kanë prit,
Ëndërra jonë sot seç u bë drit,
Na dha krahë me fluturue,
Këtë ditë së bashku me gëzue!

Kudo ushton kënga e jehona,
Pavarësi je gjithmon e jona!
Brez pas brezi do jesh krenare,
Në këtë tok me bes shqiptare!

Gjithë shqiptarve kudo janë,
Një fjalë të urtë du me u kujtu,
Amanet t'parët na e kan lane,
Vëllau me vëllan me u bashku!

KURRË S'TË HARROJ*7 Marsi - dita e mësuesit*

Mësuese e dashur, sa shumë të dua,
Ti prindi i dytë je gjithnjë për mua.
Se ti më mëson dhe më edukon,
Ndaj zemra ime sot ty të uron!

Me dashuri më mësove gjëra e pare,
E gjitha të tjerat kështu me rradhë,
Ndaj unë për ty kam shumë mallë,
Dua që gjithnjë të kemë pranë.

Të t' dhuroja lule, shëndet e mirësi plot,
Mbi faqe më rrjedhin dy-pika lot,
Edhe tani që u rrita e kudo të shkoj,
Mësuese e dashur, kurr s'do të harroj!

**TI MË DHE JETË
NGA JETA JOTE!***8 Marsi - festa e Nënës,
kushtuar Nënës*

Veç nga ti unë ekzistoj,
Ti më dhe jet nga jeta jote,
Nga krahët e tu lart fluturoj,
Hy n'miljardat e kësaj bote.

Emri jot gjithmon shpreh mall,
Vitet ikin e vitet kalojn,
Po sa herë do kem një shqetësim,
Fjala e par 'Nanë', do jesh në goj.

Ka një jetë përtej kësaj jete,
Dhe që unë shumë e besoj,
Një ditë dheu ka me na tret,
Por Zoti prap do na bashkoj!

NDJESIA E NËNËS

Të jesh një prind, është një gjë e mir,
Të jesh Nënë është ndjesi më e mir,
Fëmija është gëzimi i jetës,
Është më e madhja pjes e zemrës!

Të jesh Nënë, ke të madhin emër,
Ke më të bukrin shpirt dhe zemër,
Për mbar njerzimin je kuptimplotë,
Je e ardhmëja e kësaj Bote!

Fjala Nënë nuk zevendësohet,
Me asgjë nuk krahasohet.
Pa ty s'ndihet kurrë gëzimi,
Pa ty s'ka kuptim njerëzimi.

Ty, vetë Zoti të ka krijuar,
Këtë jetë për ta shijuar,
Me shpirtin tan të amëlsuar,
Krejt gjithësin keni zbuluar!

NATYRA

Uji rrjedhë nga mallet,
Flaka del nga zjarret,
Bari i njomë rritet në fusha,
Sa bukuri' aty ku kullot tufa.

Ah! Ky flladi i pranverës,
Seç m'ja lujti telat zemrës,
Lulet e blinit po bajnë hije,
E rradh kam pa kso bukurije!

E kjo aroma e trëndafilin,
Bashk me zanin e bylbylit,
Ma sjellin pran mua freskin,
Ma shtojn gëzimin e lumturin.

Kjo natyra me ngjyra – ngjyra,
Po shkëlqen sikur pasqyra,
Në sytë e mi rreze lëshon,
Askush si unë s'po e shijon!



Valët e detit hiç nuk pushojn,
Në kujtime larg seç më çojn,
Sikur të notoja mbi këto vale,
E ta shuaja unë çdo mallë.

Kështu vijnë Vera e Pranvera,
Pas çdo stine vijnë ditë tjera,
Shpejt natyra me kohën matet,
Që çdo njeriu t'i përshtatet.

**REDAKSIA**

Kryeredaktore: Klodjana Serraj
Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri,
Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli,
Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani,
Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziqi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

Mundësoi Botimin:
**MUNDËSOJ BOTIMIN,
Z. GJIN MARKAJ, NEW YORK**

